



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 26 (827778)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 Korrik 2022

Gjeneralmajor Shehu: Rezultatet e arritura, tregues i përgjegjësisë, seriozitetit dhe përkushtimit

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kursantëve të Kursit të Lartë të Oficerit, një prej kurseve më të rëndësishëm të Akademisë së Forcave të Armatosura. Në ceremoninë, e cila u zhvillua në ambientet e auditoriumit në Ministrinë e Mbrojtjes, ishin të pranishëm komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai, dekani i Fakultetit të Sigurisë, ambasadori i Re-

publikës së Kosovës në Tiranë z. Skënder Dymishi, komandantë forcash, pedagogë si dhe stafi mbështetës akademik. Në përshëndetjen drejtuar kursantëve, gjeneralmajor Shehu, pasi falënderoi gjithë të pranishmit, u shpreh ndër të tjera se: "Rezultatet e arritura nga ju, janë tregues i përgjegjësisë, seriozitetit dhe përkushtimit të përbashkët kursant-mësimdhënës. Studimi dhe mësimi, as nuk fillon dhe as nuk përfundon me kurset e Akademisë. Ai është një proces i pandarë dhe organik

i gjithë aktivitetit dhe shërbimit ushtarak. Akademia e Forcave të Armatosura, por edhe sistemi i edukimit, arsimimit dhe trajnimit ushtarak si një i tërë, ka qenë në një vëmendje dhe vlerësim të veçantë gjatë vitit nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe kjo ka bërë që arsimit ushtarak, programet dhe kurrikulat të jenë bashkëkohore e në mbështetje të plotë të ligjit të arsimit të lartë dhe të gjithë bazës ligjore në fuqi..." Më tej gjatë...

» faqe 2



Samiti i Madridit, 28-30 qershor 2022

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid



» faqe 3

Studentët e vitit II të programit Bachelor zhvillojnë stërvitjen "Fushim veror"

Studentët e vitit II të programit Bachelor në Shkenca Ushtarake, nën drejtimin e pedagogëve të Departamentit të Formimit Ushtarak, po zhvillojnë në rajonin e Spillesë lëndën "Fushim veror". Programi i lëndës përmban veprime praktike për ngritjen dhe funksionimin e kampingut, përgatitjen dhe organizimin e sistemit të shërbimit të ruajtjes dhe drejtim, krijimin e kushteve për punë dhe jetesë në fushim, veprime taktike në nivel toge për...



» faqe 2

Mbrojtja Ajrore, syri vigjilent i hapësirës shqiptare

1933-2022, plot 89 vjet më parë, forcave ushtarake shqiptare iu bashkëngjiti dhe një forcë e re, ajo e Mbrojtjes Kundërajrore. Në Shqipëri erdhën prej Bashkimit Sovjetik, topa kundërajrore, radarë, aparatura ndërlidhjeje, u përgatitën oficerë për këto armatime në shkollat ushtarake sovjetike dhe në ato të vendit. Në fillim të vitit 1955, ishin krijuar regjimenti kundërajror me nëntë bateri në Tiranë, grupet kundërajrore në Kuçovë, Durrës, Vlorë, ishte organizuar shërbimi i zbulimit ajror VAIN. Në Laprakë u krijua skuadrilja e avionëve JAK dhe përfunduan përgatitjet për krijimin...



» faqe 5

Kontributi humanitar i trupave xheniere, përkushtim dhe sakrificë

Më 1 korrik 1968 krijohet Brigada Xheniero-Ndërtuese, edhe pse kontributi i saj është më i hershëm, ai daton më 20 janarin e vitit 1921, ku me vendim të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua kompania e parë xheniere në përbërje të Divizionit të parë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse. Më datën 24.6.1928, për herë të parë u krijua Komanda e Trupave Xheniere. Në vitin 1929 numëroheshin gjithsej 10 nënreparte xheniere. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare...



» faqe 4

Gjeneralmajor Shehu:

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kursantëve të Kursit të Lartë të Oficerit, një prej kurseve më të rëndësishëm të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Në ceremoninë, e cila u zhvillua në ambientet e auditoriumit në Ministrinë e Mbrojtjes, ishin të pranishëm komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai, dekani i Fakultetit të Sigurisë, ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë z. Skënder Dymishi, komandantë forcash, pedagogë si dhe stafi mbështetës akademik.

Në përshëndetjen drejtuar kursantëve, gjeneralmajor Shehu, pasi falënderoi gjithë të pranishmit, u shpreh ndër të tjera se: “Rezultatet e arritura nga ju, janë tregues i përgjegjësisë, seriozitetit dhe përkushtimit të përbashkët kursant-mësues. Studimi dhe mësimi, as nuk fillon dhe as nuk përfundon me kurset e Akademisë. Ai është një proces i pandarë dhe organik i gjithë aktivitetit dhe shërbimit ushtarak.

Akademia e Forcave të Armatosura, por edhe sistemi i edukimit,

“Rezultatet e arritura, tregues i përgjegjësisë, seriozitetit dhe përkushtimit”



arsimimit dhe trajnimit ushtarak si një i tërë, ka qenë në një vëmendje dhe vlerësim të veçantë gjatë vitit nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe kjo ka bërë që arsimi ushtarak, programet dhe kurrikulat të jenë bashkëkohore e në mbështetje të plotë të ligjit të arsimit të lartë dhe



të gjithë bazës ligjore në fuqi...” Më tej gjatë përshëndetjes së saj, gjeneralmajor Shehu adresoi një falënderim të veçantë edhe për oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë këtij kursi të nivelit të lartë.

Duke përfunduar, gjeneralma-

jor Shehu falënderoi edhe personelin e Akademisë së Forcave të Armatosura për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në përfundimin me sukses të programit akademik të Kursit të Lartë të Oficerit si dhe u uroi të gjithë kursantëve të kursit, suksese në detyrat e reja që do të emërohen.

Studentët e vitit II të programit Bachelor zhvillojnë stërvitjen “Fushim veror”

Studentët e vitit II të programit Bachelor në Shkenca Ushtarake, nën drejtimin e pedagogëve të Departamentit të Formimit Ushtarak, po zhvillojnë në rajonin e Spillesë lëndën “Fushim veror”.

Programi i lëndës përmban veprime praktike për ngritjen dhe funksionimin e kampingut, përgatitjen dhe organizimin e sistemit të shërbimit të ruajtjes dhe drejtimit, krijimin e kushteve për punë dhe jetesë në fushim, veprime taktike në nivel toge për kalimin e pengesave ujore, mësim noti etj.

Gjatë gjithë zhvillimit të programit mësimor, studentët kanë demonstruar përkushtim në realizimin e tij, si dhe shpirt të lartë gare dhe grupi në aktivitetet sportive.



Fushimi është vizituar edhe nga Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, i cili ka vlerësuar angazhimin dhe përpjekjet e studentëve dhe pedagogëve për

realizimin e programit.

Mbyllja e fushimit veror, i paraprin sezonit të provimeve të semestrit të dytë për studentët e ciklit Bachelor.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s, që u zhvillua këto dy ditë në Madrid, Spanjë, si pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama.

Mbajtja e këtij Samiti 3 - ditor u vlerësua si një moment historik, për vendimet mjaft të rëndësishme që u morën për orientimin e kursit të sigurisë dhe mbrojtjes në një situatë delikate sigurie, ku Rusia dhe Kina vijojnë të sfidojnë rendin botëror të bazuar në rregullat ndërkombëtare.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili vlerësohet si një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. Në këtë Samit u theksua fakti se vendet e tij që aspirojnë për anëtarësim në strukturat euroatlantike, do të kenë mbështetjen nga Aleanca. Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden dhe sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Jens Stoltenberg vlerësuan veçanërisht rolin e Shqipërisë si aleate e NATO-s.

Qeveria shqiptare shprehu vlerësimin e saj për marrëveshjen e arritur mes Suedisë, Finlandës dhe Turqisë, që i hap rrugë anëtarësimit të dy vendeve nordike në NATO. Kryeministri Edi Rama propozoi nga ana e tij që Kosova të ftohet menjëherë në mekanizmin e Partneritetit për Paqe, duke kërkuar nga vendet që nuk e kanë njohur të vlerësojnë qëndrimin e tyre.

Kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s miratuan Konceptin e ri Strategjik të Aleancës, duke përcaktuar prioritetet kryesore dhe qasjet për adresimin e sfidave për dekadën e ardhshme. Ndryshe nga Koncepti Strategjik i vitit 2010, i cili e cilësonte Rusinë si "partner strategjik", koncepti i ri e paraqet atë si "rreziku më i madh i drejtpërdrejtë i Aleancës", ndërsa Kinën si një vend në rritje dhe me politika ambicioze për të sfiduar interesat dhe sigurinë e Aleancës.



Kontributi humanitar i trupave xheniere, përkushtim dhe sakrificë

Më 1 korrik 1968 krijohet Brigada Xheniero-Ndërtuese, edhe pse kontributi i saj është më i hershëm, ai daton më 20 janarin e vitit 1921, ku me vendim të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua kompania e parë xheniere në përbërje të Divizionit të parë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse. Më datën 24.6.1928, për herë të parë u krijua Komanda e Trupave Xheniere. Në vitin 1929 numëroreshin gjithsej 10 nënrepartet xhenierë. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, nga njësitë partizane u përdoren shumë elementë të sigurimit xhenier e të luftës me mina, edhe pse strukturat xheniere të paraluftës ishin shpërberë. Më 10 Prill të vitit 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ urdhëroi ngritjen e skuadrave të para minatore, të cilat i dhanë një efikasitet të madh veprimeve luftarake të njësisë, duke hedhur kështu bazat e ngritjes së strukturave xheniere pas çlirimit të vendit. Në korrik të vitit 1945, u krijuan nënrepartet xheniere në divizione dhe njësi e parë xheniere, e cila u vendos në Elbasan. Në vitet më vonë, repartet e njësitë xheniere u rritën e u modernizuan duke krijuar njësi të reja si Brigada e Urave në Kavajë, Brigada e Xhenios në Tiranë, si dhe tre Regjimente Xhenierë, që merreshin kryesisht me ndërtimin e objekteve mbrojtës me përmasa të mëdha, si bazat detare Porto Palermo e Shëngjin, baza ajrore Gjadër, objektet në Poliçan, Mjekës, Gramsh etj. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse, me këtë strukturë: komanda e shtabi, toga e ruajtjes, toga mbështetëse, kompania e ndërtimeve, nënreparti EOD-i, toga e urave.

Kontributi humanitar i trupave xheniere

Ai filloi menjëherë pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë me çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazistë në ikje, nga Currilat deri te Karpeni i Kavajës, me një gjatësi rreth 20 kilometra. Minime ishin kryer gjithashtu në portin e Shëngjinit, në Portin e Vlorës, në Gjirin e Semanit, të Sarandës, dhe në shumë qafa malesh e lugina. Jeta ishte e rrezikuar dhe vdekja trokiste kudo ku shkelte këmba e njerëzve të pafajshëm, që donin të ndërtonin jetën e tyre pas një lufte shkatërrimtare. Kishte ura e rrugë të shkatërruara, banesa dhe godina të rrafshuara. Në këto kushte të vështira xhenierët e batalionit të parë minator çminuan rreth 200 mijë mina kt e kk, së bashku me R1Xh të krijuar në Elbasan.

Repartet xheniere ishin të pranishëm pas luftës në rindërtimin e urës së Kuçit, mbi lumin Osum, të urës së Semanit, të urës së Vjosës, urës së Matit, të Dragotit dhe Leklit në Tepelenë e shumë ura të tjera. U ndërtuan me dhjetëra ura mekanike “Bejli” të ardhura ndihmë nga UNRRA, si shpërblim për luftën e bërë ndaj nazifashistëve dhe si vend i dëmtuar shumë në Luftën e Dytë Botërore. Dhe vazhdoi pastaj pa push-



uar asnjëherë me ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi, Gramsh-Lozhan, Çorovodë-Frashër, dhe më vonë në rrugën e Malësisë së Madhe. Xhenierët kanë qenë të pranishëm në tharjen e kënetave, në ndërtimin e kanaleve të mëdhenj bonifikues, në ndërtimin e pritave dhe argjinaturave, të hidrovo-rëve dhe ujësjellësve, kudo ku kishte nevojë vendi. Trupat xheniere nuk pushuan kurrë së vepruari në ndihmë të komunitetit për kapërcimin e fatkeqësive natyrore, në raste përmbytje, zhbllokimin e rrugëve nga dëbora, eliminimin e pasojave të tërmeteve të rënë në Dibër, Tepelenë, Sarandë, e veçanërisht në Shkodër e Lezhë, ku dëmet ishin katastrofike, kontributin e dhënë nga xhenierët për fikjen e pusit të naftës e të gazit në Marinëz, në vitin 1974 etj. Pas viteve ‘90, në kushtet e ndryshimeve të mëdha demokratike në vend dhe në rajon, trupat xheniere, hoqën dorë nga punimet fortifikuese dhe u hodhën me vull në punime kryesisht në ndihmë të komunitetit si ndërtimi i një segmenti rrugor në Unazën e madhe të Tiranës, ndërtimi i fshatit Bulçesh, Kamëz, ndërtimi i ujësjellësit në Shupenzë etj. Një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës në rrugët kryesore të vendit dhe me volum të madh punimesh janë: zgjerimi i rrugës kombëtare Llogara-Palasë në vitin 2000 (rreth 12 km), zgjerimi i rrugës kombëtare Bogovë-Çorovodë në vitin 2001 (19.5 km), ndërtimi i rrugës kombëtare Qafe Mejdan-Qafë Morinë në vitin 2002 (rreth 7.7 km), ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Prëshen, pjesë e Aksit Durrës-Kukës-Morinë në vitin 2003-2005 (10.5 km), zgjerimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Kthesa e Dajtit-Qafë Mollë në vitin 2005 (5.5 km), në interes të projektit të shkatërrimit të lëndëve kimike etj. Pjesëmarrja në emergjencat civile ka qenë një tjetër medalje e shkëlqyer e trupave xheniere,

krahas strukturave të tjera të FA-së, si zhbllokimi i rrugëve nga dëbora gjatë dimrit (dimri 2011-2012), eliminimi i pasojave nga përmbytjet, veçanërisht ajo e Shkodrës dhe Lezhës, ndërtimi e përmirësimi i shumë rrugëve në zonat rurale të vendit etj. Ndër punimet më kryesore përmendim: Gërmim shkëmbi dhe dhera të ndryshëm rreth 21 638 m³, ngarkim e transport dherash e zhavorri 5 862 m³, përhapje e nivelim dherash e zhavorri 15 265 m², rulim shtresë zhavorri 6 590 m², prishje strukturë betoni 103.5 m³, punime betoni M-200, 64,2 m³, punime suvatimi 412 m², ndërtim muri 15,9 m³, punime bojatisje 3682.5 m², ngarkim e shkarkim materiale të rëndë me vinç 91 orë pune, ndriçim natën me agregat ndriçimi 25 orë pune, shtresë asfalto-betoni 1610 m² etj. Punimet e kryera nga batalioni xhenier janë të shumta e të shumëllojshme. Nuk ka zëra pune që forcat dhe mjetet e tij të mos kenë kryer. Kjo falë edhe strukturës efikase të këtij reparti, por edhe të kapaciteteve të konsiderueshme inxhiniero-teknike dhe specialistëve që disponon, organizimit dhe drejtimit me rendiment të punëve nga komandanti dhe shtabi i batalioni dhe të nënrepartëve të tij. Në zbatim të VKM-së Nr. 931, data 09.10.2013, “Për krijimin e Taks-Forcës për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente për mbrojtjen mjedisore dhe rehabilitimin e territorit”, batalioni xhenier është angazhuar në 14 objekte për pastrimin e mbeturinave inerte të krijuara nga ndërtesat e prishura dhe sistemimin e ambienteve, si dhe në realizimin me sukses dhe pa aksidente të rrëzimit të ndërtesave, ku janë angazhuar 161 forca, 37 mjete dhe 8 agregate xhenierë. Në këto angazhime, xhenierët kanë demonstruar profesionalizëm, disiplinë të lartë dhe ndjenjë sakrifice. Nuk kanë munguar gjatë vitit 2014 edhe ndërtimi dhe riparimi i urave “Bejli”, kaq të

nevojshme nga komuniteti, veçanërisht ai rural, ku nevojat janë të shumta. Janë ndërtuar ura mekanike “Bejli” në 4 komuna, ku janë angazhuar 43 forca, 19 mjete të ndryshëm dhe 3 agregate, me një gjatësi të urave të ndërtuara 68 metra dhe ura të riparuar 15 metra. Operacionet në komunitet janë për ne “ura komunikimi”, midis ushtrisë dhe popullit, sepse ato e kanë prezantuar nga afër fytyrën humanitare të FA, i kanë bërë ato më të dashura dhe më të pranueshme. Forcat dhe mjetet e batalionit xhenier ishin ndër të parët që u gjendën pranë komunitetit edhe në rastin e emergjencës së përmbytjes në Qarkun e Lezhës nëntorin e kaluar, ku edhe në këtë rast ato demonstruan qëndrueshmëri, profesionalizëm dhe rendiment në punë në pastrimin e segmenteve rrugorë, transportimin

e materialeve inerte për bllokimin e ujërave etj. Në batalionin xhenier bën pjesë edhe nënreparti EOD-i, i specializuar dhe certifikuar nga NATO, për kryerjen e operacioneve speciale për çminim dhe asgjësimin e municioneve, i cili gjatë këtyre viteve ka kryer me qindra operacione në të katër anët e vendit, duke vënë edhe jetën në rrezik. Një tjetër nënrepart xhenier i konsoliduar dhe me vlera të veçanta është edhe kompania xheniere e luftimit, në përbërje të FT, e cila merr pjesë në përbërje të SEEBRIG-ut, Brigada e Europës Juglindore.

“Shfrytëzoj rastin për të falënderuar të gjithë punonjësit, ushtarakë e civilë, që kanë derdhur dhe derdhin djersën dhe mundin e tyre për të realizuar me sukses detyra me ngarkesë të lartë fizike dhe psikologjike dhe kanë ngritur lartë emrin e xhenierit në vite. Xhenierët kanë edhe dëshmorët e tyre. Në këtë ditë të shënuar kujtojmë me respekt kolegët tanë xhenierë që dhanë jetën e tyre për një vend të pastër nga minat e municionet e ndryshme vdekjeprurëse, që nga dëshmorit i parë xhenier, kapiteni Panajot Haxhimihali, e deri te ata të ditëve tona, siç janë oficerët Nuredin Gorçe, Aqif Karaj, Mehmet Hysa, Flamur Radani, dhe traktoristi Petrit Uku e Ilir Malçi, të cilët janë shembull frymëzimi për xhenierët.”

E kush më mirë se njerëzit që kanë qenë pjesë e këtyre strukturave, drejtues apo specialistë që kanë kontribuar një jetë me dinjitet si pjesë e FA-së, do të mund të sillte për brezat një historik të aktivitetit të njerëzve në uniformë, një prej të cilëve dhe z. Përparim Veliu, i cili ka pasqyruar një histori suksesi disa dekadash.

KOMANDA MBËSHTETËSE



Specialistët EOD eliminojnë rrezikun e municioneve të gjetura në Dibër

Efektivët EOD të batalionit të Xhenios realizuan me sukses detyrën e radhës në ndihmë të komunitetit. Operacioni për evidentimin dhe transportimin e municionit të paplasur u zhvillua me 6 forca dhe 1 mjet në fshatin Sofraçan, bashkia Bulqizë, qarku Dibër. Me një punë të kujdesshme dhe në masa të larta sigurie u zbulua 1 copë predhe topi 76 mm eksplozive me trup gize. Pas kontrollit të saj u mundësua paketimi dhe më pas u transportua dhe u magazinuara në ambientin e caktuar municionet e paplasura në batalionin e Xhenios.

Misionet

Forca **AJRORE**



Helikopteri i Forcës Ajrore EC-135 së bashku me ekuipazhin pilotë e teknikë të përkushtuar, ka kryer brenda ditës tre operacione shpëtimi, në zona të thella të vendit, në një terren të vështirë.

Helikopteri i Forcës Ajrore EC kryen tre operacione shpëtimi brenda ditës

Helikopteri i Forcës Ajrore EC-135 së bashku me ekuipazhin pilotë e teknikë të përkushtuar, ka kryer brenda ditës tre operacione shpëtimi, në zona të thella të vendit, në një terren të vështirë.

Në misionin e parë, i është ardhur në ndihmë një punonjësi të ujësjellësit të bashkisë Himarë, i cili ishte dëmtuar në Malin e Çikës, dhe më pas u transportua në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë.

Misioni i dytë u krye gjithashtu në Himarë duke i ardhur në ndihmë një gruaje me probleme kardiake, e cila u evakuua drejt spitalit nën asistencën e ekipit mjekësor.

Helikopteri EC, misionin e tretë e kreu nga Qafa e Pejës drejt spitalit rajonal të Shkodrës, duke transportuar një turistë gjermane, e cila kishte pësuar frakturë gjatë eksplorimit të zonës.



Helikopteri i Forcës Ajrore kreu dy operacione fluturuese, në shpëtim të jetëve njerëzore



Helikopteri i njësisë së transportit të shëndetësisë së Bazës Ajrore Farkë kreu dy operacione fluturuese, përkatësisht: ambulanca ajrore në Peshkopi, duke transportuar një të sëmurë dhe në Valbonë duke bërë

të mundur evakuimin e alpinistëve të lënduar në 2 328 metra lartësi në majën e Zaporrrës. Ekuipazhi i helikopterit EC kreu dy operacionet fluturuese në një kohë të shpejtë, në një terren të vështirë, gjithsej 2 orë e 50 minuta fluturim. Transportimi

përkatësisht i të sëmurit nga Peshkopia dhe alpinistëve të lënduar nga Valbona, të cilët ishin bllokuar në një zonë të thepisur, u dërguan për ndihmë të specializuar në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë.



Mbrojtja Ajrore, syri vigjilent i hapësirës shqiptare

1933-2022, plot 89 vjet më parë, forcave ushtarake shqiptare iu bashkëngjiti dhe një forcë e re, ajo e Mbrojtjes Kundërajrore. Në Shqipëri erdhën prej Bashkimit Sovjetik, topa kundërajrorë, radarë, aparatura ndërlidhjeje, u përgatitën oficerë për këto armatime në shkollat ushtarake sovjetike dhe në ato të vendit. Në fillim të vitit 1955, ishin krijuar regjimenti kundërajror me nëntë bateri në Tiranë, grupet kundërajrore në Kuçovë, Durrës, Vlorë, ishte organizuar shërbimi i zbulimit ajror VAIN. Në Laprakë u krijua skuadrilja e avionëve JAK dhe përfunduan përgatitjet për krijimin e regjimentit të aviacionit tonë luftarak në Kuçovë.

Një vend të rëndësishëm në historinë e ushtrisë tonë, zë dhe Mbrojtja Kundër-Ajrore(MKA), me qindra e mijëra ushtarakë që punuan në këtë armë me devotshmëri, të bindur se bënë detyrën ndaj popullit e atdheut. Brigada e Mbrojtjes Ajrore është arma më e vjetër e FASH, e krijuar që në vitin 1931. Sot, Brigada ka në përdorim raketa dhe topa KA, të tipave dhe kalibrave të ndryshëm. Midis tyre, janë raketat e mesme të tipit HQ-1. 4 bateri raketash HQ-1 janë të dislokuara në afërsi të Tiranës si dhe në afërsi të portit të Pashalimanit. Mbi 250-300 raketa portative të tipit HN-5A si dhe Sa-16 “Igla” përdoren nga njësitë e kësaj Brigade. Artileria kundër-ajrore përbëhet nga topa të drejtuar me radar të kalibrave 100mm, 85mm, 76mm, 56mm, 37mm, 23mm, 14.2mm si dhe njësi të shumta me mitraloza kundër-ajror 12.7mm. Në të ardhmen, shumica e sistemeve luftarake të kësaj Brigade do hiqen nga përdorimi për t’u zëvendësuar me sisteme më moderne dhe perëndimore të tipave MIM-23B “I-HAWK”, raketa portative “Stinger”, raketa SHORAD si dhe artileri kundër-ajrore më moderne. Gjithashtu, radarët e vëzhgimit të largët apo të afërt do të zëvendësohen me radarë perëndimor të firmës “Lockheed-Martin” (një radar i këtij tipi është në përdorim që nga viti 1999, dhe 4 të tjerë priten të merren në përdorim në vitet e ardhshme). Operacionet e para luftarake të FASH u ndërmorën nga Regjimenti kundërajror “Ali Demi”. Në gusht të vitit 1948 njësitë KA goditën dhe rrëzuan një avion Grek të tipit “Spitfire” që kishte shkelur hapësirën ajrore Shqiptare për mision spiunazhi. Avioni grek u shkatërrua dhe piloti u gjet i vdekur. Në gusht të vitit 1949 njësitë KA të po këtij Regjimenti goditën dhe rrëzuan një avion tjetër grek, gjatë Provokacioneve të gushtit. Avioni grek, i dëmtuar nga zjarri KA, u detyrua të ulej në fushë ku u kap nga njësitë luftarake shqiptare. Piloti grek u kap dhe u burgos si rob lufte.

Njësitë fluturuese të FASH panë aksionin e parë luftarak të tyre në vitin 1957. Më 23 dhjetor të këtij viti, një avion luftarak amerikan i tipit T-33 shkeli hapësirën ajrore shqiptare. Dy avionë të tipit MiG-15 u ngritën nga baza ajrore e Kuçovës, të pilotuar nga Anastas Ngjela dhe Mahmut Hysa. Avioni amerikan u rrethua dhe u detyrua të ulet në pistën e pambaruar të aeroportit të Rinasit. Avioni u sekuestrua dhe piloti amerikan u kap rob. Piloti amerikan u lirua më 11 janar 1958, ndërsa avioni u vendos në muzeun e kështjellës së Gjirokastrës, ku ndodhet edhe sot. Në vitin 2015 artisti vizual Armando Lulaj ringriti simbolikisht në ajër avionin amerikan gjatë realizimit të filmit me metrazh të shkurtër “Përsëritje”.

Më 31 dhjetor, të po këtij viti, vetëm disa ditë më vonë nga ky incident, një avion tjetër i huaj shkeli hapësirën ajrore Shqiptare. Ky ishte një avion transporti i tipit DC-7 i “Independent Air Travel”, që po fluturonte nga Gjermania drejt Singaporit. Dy avionë të tipit MiG-15 u lëshuan për ta kapur. Transportuesi u rrethua dhe u detyrua të ulej në aeroportin e Kuçovës. Të 5 pilotët dhe avioni civil u liruan më pas, më 4 janar 1958 mbasi u vendos që ishte vetëm një gabim navigacioni. Më 31 dhjetor 1958, një avion tjetër i huaj u kap nga avionët reaktivë të bazës së Kuçovës. Ky ishte një C-54D “Skymaster”, që përdorej nga CIA për të transportuar armë në Indonezi. Avioni u detyrua të ulej në bazën e Kuçovës, dhe më pas pilotët dhe avioni u liruan për t’u kthyer në Angli. Një fitore e rëndësishme kjo e FASH.

Në 21 korrik 1967 një incident i rëndë ndodhi mbi hapësirën ajrore shqiptare. Një avion jugosllav i tipit F-84 “Thunderjet”, i armatosur me raketa të pa drejtuar dhe bomba, shkeli hapësirën ajrore të Shqipërisë në afërsi të Dibrës, duke fluturuar në drejtimin Peshkopi-Martanesh-Tiranë. Avioni jugosllav me numër regjistrimi 11 ishte i dislokuar në aerodromin ushtarak të Zemunit, rreth 15-20 km në veri-perëndim të Beogradit. Avioni pilotohet nga Boidar Vojevic dhe detyra e tij ishte të fluturonte për në aerodromin ushtarak të Kumanovës, Maqedoni, ku do të merrte pjesë në stërvitje. Shërbimet e radarit nuk arritën të diktonin shkeljen e hapësirës ajrore të Shqipërisë për shkak se avioni jugosllav fluturonte ulët duke ndjekur relievin. Avioni u diktua vetëm kur ai iu afrua bazës së Forcave Ajrore në Rinas. Pilotë të gatshëm ishin Koço Biku dhe Roland Sofroni. 3 avionë reaktivë të tipit MiG-19, të komanduar nga pilotët Koço Biku, Mahmut Hysa dhe Gëzdar Veipi, u ngritën nga baza ajrore e Rinasit për të interceptuar avionin jugosllav. Avioni jugosllav u rrethua dhe u detyrua të ulej në aerodromin e Rinasit. Mbas uljes, piloti jugosllav deklaroi se ai kishte humbur orientimin gjatë fluturimit. Avioni dhe piloti u kthyen në Jugosllavi mbas një marrëveshjeje mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

E shpërndarë në gjithë territorin e vendit, Arma e Mbrojtjes Kundërajrore në vite ka qenë objektivi i parë që kërkonte modernizim dhe përkushtim, çka nuk ka mundur dhe nga ushtarakët e kësaj arme.

Ceremonia

Forca **DETARE**

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, vlerësoi punën dhe kontributin e nënkolonel Shpresa Gjinit, në Forcën Detare.

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ceremonia me rastin e daljes në pension të nënkolonel Shpresa Gjinit.

Në ceremoni mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila u shpreh: “Ndihem e vlerësuar të marr pjesë në këtë ceremoni, ku përcjellim një nënkolonele, nënë, bashkëshorte model që ka shërbyer për tridhjetë e pesë vjet në Forcat e Armatosura”.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, vlerësoi punën dhe kontributin e nënkolonel Shpresa Gjinit, në Forcën Detare.

Në vijim të ceremonisë, nënkolonel Shpresa Gjinit, iu dorëzua “Certifikata e Mirënjohjes”, akorduar nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, për kontributin e dhënë ndër vite në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu iu akordua “Certifikatë Mirënjohje nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra, falënderim dhe mirënjohje për kontributin e dhënë ndër vite në Forcën Detare.

Zhvillohet ceremonia me rastin e daljes në pension të nënkolonel Shpresa Gjinit



Batalioni i Parë i Këmbësorisë mori pjesë në stërvitjen ndërkombëtare të titulluar “Bright Armour” në Itali, duke treguar disiplinë dhe nivel të lartë profesionalizmi

Forca **TOKËSORE**

Përfundon stërvitja e dytë 72-orëshe, e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë

Gjatë kësaj stërvitjeje, u testuan të gjithë kapacitetet operacionale të GBKL, me mbështetjen e ekipit trajnues amerikan të SFAB.



ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

A është e vështirë të jesh njeri i mirë në një botë ku egoizmi lufton të jetë pjesë e lartësimit të vlerave njerëzore? Sigurisht që po. Po nuk është e pamundur të sfidosh negativitetin, duke dhënë më të mirën tënde. Prandaj mjafton të jesh i mirë. Problemi fillon atëherë kur e mira duhet të ndahet nga e keqja. Çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, është relative. Ka shumë pak modele të së mirës në këtë botë, dhe nga ata sot kemi mësuar se cilat janë cilësitë më të mira për cilindo person.

Njerëzit e mirë janë të ndershëm?

Ndershmëria është mënyrë jetese. Këta njerëz nuk vjedhin, nuk mashtrojnë dhe janë besnikë. Nuk i tradhetojnë miqtë dhe vendosin idealet përpara interesave.

Njerëzit e mirë janë të lumtur?

Lumturia nuk ka të bëjë me paratë, pamjen apo statusin. Njerëzit e mirë janë sinqerisht mirënjohës për atë që kanë, dhe mezi presin agimin për te rilindur me Diellin dhe për të falënderuar Zotin. (Shpesh lumturia e tyre është ngjitëse.)

Njerëzit e mirë janë të respektueshëm?

Ata i trajtojnë të tjerët sikurse duan të trajtohen. Respektojnë ata që i rrethojnë pa dallim, të qenit njerëzor për ta është obligim.

Njerëzit e mirë kanë besim?

Jo gjithnjë kjo mund të jetë një cilësi e mirë, sidomos në arenën mishngrënëse ku kemi fatin të jetojmë. Por njerëzit e mirë kanë besim te ata që i rrethojnë, në të kundërt nuk mund të qëndrojnë me ta.

Njerëzit e mirë janë të vetë-disiplinuar?

Vetë-disiplina është ndershmëria për të zgjedhur çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat. Njerëzit e mirë janë mjaft të fortë për t'i thënë jo tundimeve të shumta të jetës.

Njerëzit e mirë krenohen me veten e tyre?

Ndërkohë që ditët e sotme krenaria e tepërt shihet si mëkatore, njerëzit e mirë ndihen krenarë për atë që janë, atë që jetojmë dhe çfarë bëjnë. Kjo lloj krenarie i ndihmon të përcaktojnë se çfarë simbolizojnë në këtë botë.

Njerëzit e mirë janë të mëshirshëm?

Ata janë empatikë ndaj nevojave të të tjerëve dhe bëjnë vepra të mira për të lehtësuar vuajtjet e atyre që i rrethojnë. Ky është një nga veprimet më themelore të mirësisë që njerëzit e mirë bëjnë si qenie njerëzore.

Jemi njerëz dhe shpesh e konsiderojmë veten superiorë, zotërues të tokës ku jetojmë dhe të aftë të marrim lehtë atë ç'ka duam.

A është e drejtë ta quajmë veten si qenien më komplekse?

Pse duhet të konsiderohemi në majë të piramidës së evolucionit kur ka plot kafshë të tjera me aftësi që ne nuk i kemi?

Vjen një moment kur njeriu, i cili gënjen veten dhe dëgjon gënjeshttrat e veta, nuk mund të dallojë të vërtetën brenda tij, e as përreth tij, dhe kështu e humb gjithë respektin për vete dhe për të tjerët. Dhe duke mos pasur respekt ai pushon së dashuruari, së ndjeri, humb nuhatjen e qenies humane.

Në kërkim të një emri



Nuk jemi as vrapuesit e as notarët më të shpejtë, shqisat tona kanë ndijime shumë më të dobëta se të kafshëve të tjera, nuk jemi ata që orientojnë lehtë me diellin, nuk mund të shohim mirë natën, dhe përsëri mbahemi si qeniet më të forta, më të përshtatura dhe dominante në planet.

Ç'jemi?

U bë mijëra vjet që nuk përgjigjemi dot. Kemi arritur të zhbirojmë galaktikat, të ndajmë atomin, të gjurmojmë dritën, dhe ende s'jemi marrë me veten tonë.

Ka një pengesë, ndoshta sepse njeriu e ka të vështirë të përkufizojë veten e vet, e ka të vështirë të eksperimentojë me specien e vet, ose ndoshta mendja jonë është e projektuar në atë mënyrë që të mos zbulojë të fshehtat tona.

Disa thonë se njeriu është një kafshë me arsye. Kafshë na bëjnë instinktet. Instinktet na shtyjnë të plotësojmë nevojat bazë për të jetuar.

ID-ja, thotë Frojdi, është një pjesë e errët, në nënndërgjegjen tonë, ku në mënyrë kaotike zhvillohen instinktet: uria, etja, uria seksuale dhe ruajtja nga dhimbja. Këto i kemi të përbashkëta me gjithë kafshët, ndërsa ato që na diferencojnë janë dëshirat tona dhe kufizimet që na ve shoqëria.

Egoja na bën të realizojmë një set funksionesh psikologjike: gjykimin,

ambicien deluzionin, agresivitetin, me pak fjalë, gjithçka që mund të na duhet për të plotësuar nevojat që vijnë nga zëri i brendshëm i instinkteve. Superegoja është ajo ç'ka i frenon instinktet tona kafshërore, na bën njerëz të aftë të jetojmë në një shoqëri ku ka kufizime morale, shoqërore. Ndërsa instinktet na shtyjnë të veprojmë në një mënyrë tërësisht të lirë, superegoja na kufizon, na tregon ç'është e mirë dhe ç'është e keqe, si duhet të veprojmë drejt në një mjedis ndërveprues.

Njeriu ka në dorë sjelljen e tij, përshtatjen dhe intelektin. S'mund të konsiderohemi si kafsha më e sofistikuar pa futur në lojë arsyen tonë, atë ç'ka na diferencon dhe na bën të bashkëvepruëm. Pa tolerancë, pa komunikim, qenia njerëzore, e cila dikur jetonte e vetme, si një gjuetare e thjeshtë, nuk do të organizohej për të krijuar struktura më komplekse, ku ndeshen bashkë interesat e përbashkëta, por dhe ato të ndryshme.

Njeriu është një epiqendër emocional dhe ndjenjash. Ngacmimet më të forta njerëzit i marrin nga një proces i veçantë; jo nga dhimbja apo uria siç mund të ndodhte tek kafshët, por nga ngjarje, ndodhi që shkaktojnë emocione. Njerëzit kanë thënë që vdekja është vdekja e tjetrit, që dashuria është motori që lëviz botën... Njerëzit ia atribuojnë jetën e vetë ndjenjave, janë

pre e tyre. Ndjenjat influencojnë aq shumë sa çdo veprim joni varet nga to, nga gjendja jonë shpirtërore. Njerëzit shtrojnë pyetjen nëse duhet vepruar me arsye apo me zemër. Njerëzit besojnë dhe kanë shpresë, me pak fjalë jemi shumë të veçantë, pikërisht nga kjo pjesë që na bën njerëzore, nga ndjenjat humane, ato që na mbrojnë nga instinktet e egra që duan thjesht mbijetese.

Vjen një moment kur njeriu, i cili gënjen veten dhe dëgjon gënjeshttrat e veta, nuk mund të dallojë të vërtetën brenda tij, e as përreth tij, dhe kështu e humb gjithë respektin për vete dhe për të tjerët. Dhe duke mos pasur respekt ai pushon së dashuruari, së ndjeri, humb nuhatjen e qenies humane.

Brenda kulturës sonë duket disi absurd gjykimi, se njeriu mund ta njohë veten vetëm nëpërmjet tjetrit.

Duket si një ide e papranueshme që i ul gjithkujt personalitetin e vet dhe e privon nga pavarësia e gjykimeve dhe e vlerësimeve mbi veten dhe tjetrin.

Mjafton të hedhim një sy në marrëdhëniet e përditshme midis njerëzve për të kuptuar se sa vuajnë ata nga kjo mendësi e nisjes nga vetja.

Komshinj që kanë mendime për-buzëse për njëri-tjetrin, familjarë që brenda pak minutash diskutimi përfundojnë në grindje apo në gjendje nervozizmi, e cila i vë kapak çdo diskutimi.

Kjo gjendje e fundit vihet re në

shumë marrëdhënie midis prindërve dhe fëmijëve, të cilët pastaj ankohen në mjedise të caktuara se e kanë të pamundur të merren vesh me njëri-tjetrin.

Në këtë mënyrë ajo që njeriu njeh te vetja e tij dhe imazhi i personalitetit të tij në këndvështrimet e opinionit të tjetrit mund të kenë një dallim pak a shumë të konsiderueshëm midis tyre.

I njëjti personalitet, i parë nga vetja dhe i parë nga të tjerët, përthihet nën prizma të ndryshme, dhe merr për rrjedhojë përmbajtje të larmishme...

Nga kjo pikëpamje kuptohet se për të ditur se cili është realisht, nuk mjafton që një politikan të dijë se si e mendon ai vetë veten e tij, por edhe sesi e mendojnë atë të tjerët, pikërisht ata që nuk mendojnë njësoj si ai.

Njohja e vetes nuk kalon vetëm nëpërmjet gjykimeve që gjithkush ka për veten e tij, por edhe duke njohur se si e vlerësojnë atë të tjerët.

Të dyja planet kanë rëndësi, por ndërsa i pari ka vetëm vlerë subjektive, i dyti ka paradoksalisht një vlerë objektive sepse përbën masën me të cilën e mat këdo shoqëria, mjedisi i jashtëm që e rrethon atë.

Për të gjitha këto arsye "Njeri, mos njih vetëm vetveten, por njih vetveten nëpërmjet tjetrit".

E kërkova një emër, nuk di pse kudo gjeta emrin tënd, timin, tuajin.

SAMITI I MADRIDIT, 28-30 QERSHOR 2022

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Ndërsa Spanja shënon këtë vit 40-vjetorin e anëtarësimit në Aleancë, liderët e vendeve të NATO-s u takuan në Madrid, në Samitin e tyre tre ditor nga 28 deri më 30 qershor 2022. Udhëheqësit e qeverive dhe vendeve të NATO-s morën vendime të gjera për të vazhduar përshtatjen e Aleancës në sesionin e parë të punës në Samitin e Madridit zhvilluar më 29 qershor. Aleatët miratuan Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, planin për Aleancën në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese. Vendosi gjithashtu për një ndryshim themelor në parandalimin dhe mbrojtjen, të mbështetur nga rritja e investimeve në mbrojtje dhe financimi i përbashkët, si dhe vendosën për më shumë mbështetje për Ukrainën, për një afat më të gjatë.

Aleatët ranë dakord më tej për të nisur Fondin e Inovacionit të NATO-s dhe për të vendosur objektiva për të ulur emetimet e gazit serrë të NATO-s. Më në fund, udhëheqësit e NATO-s morën vendimin e tyre historik, siç ishte ftesa për Finlandën dhe Suedinë, për tu bërë anëtarë të Aleancës.

Aleatët, mbështetje të vazhdueshme për Ukrainën

“Udhëheqësit e NATO-s sapo kanë marrë vendime për të transformuar dhe forcuar Aleancën tonë në këtë kohë kyçe për sigurinë tonë. Lufta e Presidentit Putin kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen në Europë dhe ka krijuar krizën më të madhe të sigurisë në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. NATO është përgjigjur me forcë dhe unitet. Liderhipi dhe guximi i Presidentit Zelenskyy janë një frymëzim për të gjithë ne”, -tha në daljen para shtypit Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, kur informoi mbi punimet e datës 29 qershor të Samitit. “Presidenti Zelenskyy e bëri të qartë se Ukraina mbështetet në mbështetjen tonë të vazhdueshme dhe mesazhi ynë për të ishte po aq i qartë. Ukraina mund të mbështetet tek ne, për aq kohë sa duhet”, -tha ai. “Aleatët do të vazhdojnë të ofrojnë ndihmë të madhe ushtarake dhe financiare dhe udhëheqësit ranë dakord të forcojnë mbështetjen tonë, duke rënë dakord për një Paketë Gjithëpërfshirëse të Asistencës për Ukrainën. Kjo përfshin komunikime të sigurta, karburant, furnizime mjekësore dhe armaturë trupore. Pajisjet për të luftuar minat dhe kërcënimet kimike dhe biologjike dhe qindra sisteme portative anti-drone. Në planin afatgjatë, ne do të ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga pajisjet e epokës sovjetike në pajisjet moderne të NATO-s, për të rritur ndërveprimet dhe të forcojë më tej institucionet e saj të mbrojtjes dhe sigurisë. E gjithë kjo tregon përkushtimin tonë për të ardhmen e Ukrainës dhe se angazhimi ynë është i palëkundur. Një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike.”

Transformimi i Forcës së Reagimit të NATO-s, numri i forcave shkon mbi 300 000

Krerët e shteteve dhe qeverive të NATO-s vendosën më 29 qershor gjithashtu për një ndryshim thelbësor në mbrojtjen dhe parandalimin e NATO-s, për t’iu përgjigjur realitetit të ri të sigurisë. “Ne do të forcojmë mbrojtjen tonë përpas. Ne do të rrisim grupet tona luftarake në pjesën lindore të Aleancës, deri në nivel brigade. Ne do të transformojmë Forcën e Reagimit të NATO-s dhe rritjen e numrit të forcave të gatishmërisë së lartë në mbi 300 000”, -njoftoi mediet Stoltenberg. “Ne gjithashtu do të rrisim aftësinë tonë për të përforcuar, përfshirë: më shumë pajisje të para-pozicionuara dhe rezerva të furnizimeve ushtarake; më shumë aftësi të vendosura përpas, si mbrojtja ajrore; komandim dhe kontroll

Koncepti i ri Strategjik, forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes, më shumë mbështetje për Ukrainën, ftesa për Finlandën dhe Suedinë

NATO njuh Rusinë si kërcënimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë



i forcuar dhe planet e përmirësuar të mbrojtjes, me forca të paracaktuara për të mbrojtur aleatët specifikë”, -tha ai dhe shtoi se: “Kjo është hera e parë që nga Lufta e Ftohtë që NATO ka plane të tilla me forca të paracaktuara. Këto forca do të punojnë me forcat e mbrojtjes në vend dhe do të familjarizohen me terrenin lokal, objektet dhe stoqet e para-pozicionuara, që të mund të përforcoheni edhe më shpejt”.

Rritja e shpenzimeve të mbrojtjes, investim në aftësi moderne

Të bësh më shumë do të kushtojë më shumë. Aleatët u angazhuan për zotimin që bënë në 2014 për të shpenzuar të paktën 2% të PBB-së për mbrojtjen. Që nga viti 2014, aleatët europianë dhe Kanadaja kanë shpenzuar 350 miliardë dollarë shtesë. Nëntë aleatë tani arrijnë, ose tejkalojnë objektivin prej 2%. Nëntëmbëdhjetë aleatë kanë plane të qarta për ta arritur atë deri në vitin 2024 dhe pesë të tjerë kanë angazhime konkrete për ta përmbushur atë më pas. Dy për qind shihen gjithnjë e më shumë si dysheme, jo si tavan. Aleatët po investojnë gjithashtu më shumë në aftësitë moderne, duke kontribuar më shumë në dislokimet dhe stërvitjet e NATO-s. “Ne kemi rënë dakord të rrisim financimin e përbashkët të NATO-s. Për të financuar objektet kemi nevojë për përforsim si dhe për më shumë trajnime dhe më shumë stërvitje, komandim dhe kontroll, dhe angazhim me partnerët. Ne përballemi me një ndryshim rrënjësor në mjedisin tonë të sigurisë dhe konkurrenca strategjike po rritet në mbarë botën”. Stoltenberg tha se: “aleatët e NATO-s reduktuan shpenzimet e mbrojtjes pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, por nëse ne reduktojmë shpenzimet e mbrojtjes kur tensionet po rriten dhe kur jetojmë në një botë më të rrezikshme”. Prandaj fakti që të gjithë aleatët e NATO-s kanë rritur shpenzimet është një mesazh për të gjithë aleatët, për kapacitetet, kontributet në misionet dhe operacionet e NATO-s.

Samiti miraton Konceptin e ri Strategjik të NATO-s

Krerët e shteteve dhe qeverive të NATO-s në takimin në Madrid në punimet e 29 qershorit 2022, miratuan Konceptin e ri Strategjik për Aleancën,

ku përcaktuan prioritetet, detyrat kryesore dhe qasjet e Aleancës për dekadën e ardhshme. Koncepti përshkruan mjedisin e sigurisë me të cilin përballet Aleanca, ripohon vlerat dhe përshkruan qëllimin kryesor të NATO-s për të siguruar mbrojtjen kolektive. Ai më tej përcakton tre detyrat kryesore të NATO-s për parandalimin dhe mbrojtjen; parandalimin dhe menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese.

“Ky është Koncepti i ri Strategjik. Ai që kishim, ishte rënë dakord në vitin 2010 dhe kjo është shumë e ndryshme nga ajo që ranë dakord atëherë”, -nënvizoi shefi i NATO-s. “Ky koncept e bën të qartë se Rusia përbën kërcënimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë tonë. Në konceptin aktual, (të mëparshmin) ne deklarojmë se Rusia është një partner strategjik dhe ne nuk e përmendim Kinën me asnjë fjalë të vetme. Ndërsa në konceptin e ri, aleatët deklarojnë se politikat shtrënguese të Kinës sfidojnë interesat, sigurinë dhe vlerat tona. Koncepti gjithashtu përcakton qëndrimin tonë të përbashkët për të luftuar terrorizmin, si dhe kërcënimet kibernetike dhe hibride. Koncepti Strategjik përditësohet afërsisht çdo dekadë dhe është dokumenti i dytë më i rëndësishëm i NATO-s. Ai ripohon vlerat e Aleancës, ofron një vlerësim kolektiv të sfidave të sigurisë dhe drejton aktivitetet politike dhe ushtarake të Aleancës. Versioni i mëparshëm u miratua në Samitin e NATO-s në Lisbonë në 2010.

Përshtatja e NATO-s dhe ndryshimi i klimës si një sfidë përcaktuese

Hapa të tjerë të rëndësishëm për të vazhduar përshtatjen e NATO-s u ndërmorën në Samit. “Ne po hapim Fondin e Inovacionit të NATO-s. Mbështetur nga aleatët, ai do të investojë 1 miliard euro në start-up-e dhe fonde që zhvillojnë teknologji të reja me përdorim të dyfishtë, si inteligjenca artificiale. Së bashku me Përsheptuesin e Inovacionit të Mbrojtjes të NATO-s për Atlantikun e Veriut, ose DIANA, fondi i ri do të shfrytëzojë teknologjinë e re më të mirë për sigurinë transatlantike. Nga ana tjetër ndryshimi i klimës është një sfidë përcaktuese e kohës sonë. NATO është e përkushtuar të luajë rolin e saj në zbutjen e ndikimit në sigurinë e saj. Sot, ne ramë dakord për një metodologji të re për të hartuar emetimet ushtarake të gazeve serrë. Ne ramë dakord për

objektiva konkretë për të ulur emetimet e NATO-s. Synimi ynë është të ulim emetimet nga organet dhe komandat e NATO-s me të paktën 45% deri në vitin 2030 dhe të shkojmë drejt Neto Zero deri në vitin 2050. Ky është një hap i rëndësishëm për Aleancën tonë”, -tha Stoltenberg. “Ne nuk mund të zgjedhim mes ushtrive të gjelbra apo të forta, duhet të jenë të dyja, -tha ai. -Pra, ne duhet të ruajmë efektivitetin dhe gatishmërinë tonë operacionale ndërsa vazhdojmë të përshtatem.”

Adresimi i sfidave globale, partnerët Indo-Paqësor marrin pjesë në një Samit të NATO-s për herë të parë

Në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese, NATO-s i duhet të punojë edhe më ngushtë me kombet dhe organizatat me të njëjtin mendim. Prandaj në Samitin e Madridit, liderëve aleatë iu bashkuan gjatë punimeve disa prej partnerëve më të afërt të NATO-s për të adresuar sfidat globale. Partnerët Indo-Paqësor Australia, Japonia, Zelandia e Re dhe Republika e Koresë morën pjesë për herë të parë në një Samit të NATO-s. Në takim morën pjesë edhe BE dhe Gjeorgjia, si dhe Finlanda dhe Suedia, ku dy të fundit në datën 29 qershor u ftuan të bëhen anëtarë të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO duhet të qëndrojë me partnerët e saj në mbarë botën për të ruajtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla në epokën e konkurrencës strategjike. “Ne shohim një partneritet strategjik të thelluar midis Moskës dhe Pekinit dhe vetëbesimi në rritje i Kinës dhe politikat e saj shtrënguese kanë pasojë për sigurinë e aleatëve dhe partnerëve tanë”, -tha ai për mediat pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive me partnerët. “Kina po ndërton mënyrë të konsiderueshme forcat e saj ushtarake, përfshirë armët bërthamore, ngacmimin e fqinjëve, kërcënimin i Tajvanit, investimi i madh në infrastrukturën kritike, përfshirë vendet aleate, monitorimi dhe kontrolli i qytetarëve të vet përmes teknologjisë së avancuar dhe përhapja e gënjeshtreve dhe dezinformatave ruse”, -tha Stoltenberg. “Kina nuk është kundërshtari ynë, por ne duhet të jemi të qartë për sfidat serioze që ajo përfaqëson dhe ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë me partnerët tanë për të ruajtur rendin

ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Një sistem global i bazuar në norma dhe vlera, në vend të dhunës brutale. NATO do të rrisë bashkëpunimin me partnerët tanë Indo-Paqësor, përfshirë mbrojtjen kibernetike, teknologjitë e reja, sigurinë detare, ndryshimet klimatike dhe kundër-informimin, sepse këto sfida globale kërkojnë zgjidhje globale. Në takim u ra dakord të shtohet mbështetja politike dhe praktike për partnerët e tjerë në rrezik nga agresioni rus, si me Bosnjën dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë dhe Republikën e Moldavisë. “Ne do t’i ndihmojmë ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre”.

Vendim historik, ftesa për Finlandën dhe Suedinë për t’u bërë anëtarë të NATO-s

“Sot, liderët e NATO-s morën vendimin historik për të ftuar Finlandën dhe Suedinë të bëhen anëtarë të NATO-s. Marrëveshja e arritur mbrëmë (28 qershor) nga Turqia, Finlanda dhe Suedia i hapi rrugën këtij vendimi”, -tha shefi i NATO-s. “Do të doja të falënderoja Turqinë, Finlandën dhe Suedinë që pranuan ftesën time për t’u përfshirë në negociata për të gjetur një rrugë të bashkuar përpas. Kjo ka qenë punë e vështirë për shumë javë, me kontakte të shumta në nivele të ndryshme. Zyrtarët e lartë kanë pasur dy raunde bisedimesh në Bruksel nën kujdesin tim. Dhe mbrëmë, ne u takuam me Presidentin Erdogan, Presidentin Niinistö dhe Kryeministrin Andersson dhe arritëm në marrëveshjen përfundimtare. Kjo është një marrëveshje e mirë për Turqinë. Është një marrëveshje e mirë për Finlandën dhe Suedinë dhe kjo është një marrëveshje e mirë për NATO-n”, -deklaroj Stoltenberg. “Para së gjithash, vendimi për të ftuar Finlandën dhe Suedinë për t’u bërë anëtare tregon se dera e NATO-s është e hapur. Kjo tregon se presidenti Putin nuk ia doli të mbyllte derën e NATO-s. Dera e NATO-s mbetet e hapur dhe gjithashtu tregon se ne respektojmë të drejtën sovranë të çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij. Pra, ne, natyrisht, e respektojmë Finlandën dhe Suedinë kur vendosën të qëndronin jashtë NATO-s për shumë vite, por më pas i mirëpritëm dhe respektoam vendimin e tyre për t’u anëtarësuar në NATO”, -theksoi Sekretari i Përgjithshëm. Aleatët e NATO-s tashmë janë rritur dhe NATO ka rritur praninë e saj në rajonin Baltik, Nordik. “Sigurisht, kur ata të bëhen anëtarë, ne mund të bëjmë edhe më shumë së bashku. Ajo që ne do të sigurohemi me praninë tonë është se ne jemi në gjendje të mbrojmë të gjithë aleatët, përfshirë, natyrisht, Finlandën dhe Suedinë.”

Ky është procesi më i shpejtë i anëtarësimit të një vendi ndonjëherë në NATO. Finlanda dhe Suedia aplikuan për anëtarësim në maj, dhe në fund të qershorit liderët i ftuan ata të bëhen anëtarë. “Pas nënshkrimit të Protokollit të Anëtarësimit është ratifikimi në tridhjetë parlamente të vendeve aleate dhe mesazhi në sallë ishte se në të gjithë Aleancën ekziston një vullnet i fortë për të punuar me parlamentet në mënyrë që ata të mund të bëjnë ratifikimin sa më shpejt të jetë e mundur”, -njoftoi Stoltenberg, lidhur me procedurat e mëtejshme në vendet aleate të NATO-s.

SHBA shton kapacitet ushtarake në Europë

Sekretari i Përgjithshëm mirëpret Presidentin e SHBA-së në Samitin e NATO-s: Deklaratat

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti Presidentin e SHBA-ve Joe Biden në Samitin e NATO-s në Madrid të mërkurën (më 29 qershor 2022). Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Presidentin Biden për udhëheqjen e tij vendimtare në forcimin e lidhjes transatlantike gjatë luftës së Rusisë ndaj Ukrainës, e demonstruar nga njoftimi i Presidentit për të rritur më tej praninë e SHBA-së në Europë.

Stoltenberg falënderoi gjithashtu Presidentin Biden për mbështetjen e palëkundur të ofruar nga Shtetet e Bashkuara për Ukrainën dhe tha se ai priste me padurim një samit historik dhe transformues.

Deklarata nga Presidenti i SHBA-së, Joe Biden dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në fillim të Samitit të NATO-s 2022

Presidenti amerikan Biden:

I dashur Jens, faleminderit shumë që më keni pritur këtë mëngjes dhe ju e dini që kemi një agjendë të madhe. Është mirë që jam me ju për të filluar. Mendoj se është një Samit historik, dhe ne folëm për këtë para një viti dhe tani jemi këtu. Takimi ynë është sot. Ne do të miratojmë një Koncept të ri Strategjik të NATO-s dhe do të riafirmojmë unitetin dhe vendosmërinë e Aleancës sonë për të mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s.

Neni i pestë është i shenjtë. Ne e kuptojmë atë kur themi “një sulm kundër njërit është një sulm kundër të gjithëve”, çdo centimetër dhe kështu, në këtë samit, Aleanca e plotë do të mirëpresë Finlandën dhe Suedinë. Një aplikim historik për anëtarësim dhe vendimi i tyre për t’u larguar nga neutraliteti, tradita e neutralitetit, për t’u anëtarësuar në Aleancën e NATO-s. Kjo do të na bëjë më të fortë dhe më të sigurt, dhe NATO-n më të fortë. Ne po dërgojmë një mesazh të pagabueshëm, sipas mendimit tim, dhe mendoj se edhe juaji, se NATO është e fortë, e bashkuar dhe hapat që po ndërmarrim gjatë këtij Samiti do të rrisin më tej forcën tonë kolektive.

Për këtë qëllim, sot, unë po njoftoj se Shtetet e Bashkuara do të përmirësojnë qëndrimin tonë të forcës në Europë dhe do t’i përgjigjen mjedisit të ndry-



shuar të sigurisë, si dhe do të forcojnë sigurinë tonë kolektive.

Në fillim të këtij viti, ne dërguam 20 000 forca shtesë amerikane në Europë për të forcuar Aleancën tonë në përgjigje të lëvizjes agresive të Rusisë, duke e çuar forcën tonë totale në Europë në 100 000. Ne do të vazhdojmë të rregullojmë qëndrimin tonë bazuar në kërcënimin, në konsultim të ngushtë me aleatët tanë.

Këtu në Spanjë, ne do të punojmë me aleatët tanë për të rritur shkatërruesit e marinës amerikane të stacionuar në bazën detare Rota të Spanjës, nga katër në gjashtë shkatërrues. Në Poloni, ne do të krijojmë një seli të përhershme të Korpusit të Pestë të Ushtrisë së SHBA dhe do të forcojmë ndërveprimin SHBA-NATO në të gjithë krahun lindor. Ne do të mbajmë një brigadë shtesë rrotulluese, e cila ka 3 000 luftëtarë dhe 2 000 persona të tjerë, ekip luftarak këtu në Europë, me seli në Rumani dhe ne do të përmirësojmë dislokimet tona rrotulluese në shtetet baltike. Ne do të dërgojmë dy skuadronë shtesë F-35 në MB dhe do të stacionojmë mbrojtje ajrore shtesë dhe kapacitete të tjera në Gjermani dhe Itali. Së bashku me aleatët tanë, ne do të sigurohemi që NATO të jetë gati për të përballuar kërcënimet nga të gjitha drejtimit, në çdo fushë: tokë, ajër dhe det.

Ne jemi duke u rritur, duke dëshmuar se NATO-ja është më e nevojshme tani se sa ka qenë ndonjëherë dhe është po aq e rëndësishme

sa ka qenë ndonjëherë.

Kështu që unë dua t’ju falënderoj, Jens, për udhëheqjen e Aleancës përmes kësaj krize dhe për punën tuaj për të forcuar NATO-n për të gjitha sfidat që janë përpara. Dhe me të vërtetë pres me padurim diskutimet tona. Dhe përsëri, faleminderit për udhëheqjen tuaj. Është e rëndësishme.

Sekretar i Përgjithshëm:

Faleminderit shumë, President Biden, i dashur Joe.

Është vërtet mirë që të shoh këtu në Madrid, kaq shpejt pasi u takuam në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Faleminderit për udhëheqjen tuaj personale dhe përkushtimin e SHBA-së ndaj NATO-s, ndaj sigurisë europiane të demonstruar nga njoftimet që sapo keni bërë për të rritur më tej praninë e SHBA-së në Europë. Kjo vërtet tregon leadershipin tuaj vendimtar në forcimin e lidhjes transatlantike. Dhe ne e shohim gjithashtu këtë në mbështetjen e palëkundur nga ju dhe nga Shtetet e Bashkuara në Ukrainë. Kjo do të jetë një çështje kryesore në Samitin e sotëm.

Ne do të takohemi me Presidentin Zelenskyy, ai do të flasë në Samit. Dhe siç thatë ju, ky do të jetë një samit historik. Do të jetë një Samit transformues, ku ne do të marrim vendime që do të ndryshojnë në fakt këtë Aleancë për shumë vite në vijim. Ne do të pajtohemi me një Koncept të ri Strategjik, planin për NATO-n në të ardhmen, një botë më të rrezikshme, një botë më konkurruese. Ne do të biem dakord për

ndryshimin më të madh të mbrojtjes dhe parandalimit tonë kolektiv që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Dhe SHBA është sigurisht shumë pjesë e kësaj.

Dhe pastaj, ne do të ftojme Finlandën dhe Suedinë që të anëtarësohen në NATO. Dhe kjo tregon se dera e NATO-s është e hapur. Kjo tregon se presidenti Putin nuk ka arritur të mbyllë derën e NATO-s. Ai po merr të kundërtën e asaj që dëshiron. Ai do më pak NATO. Presidenti Putin po merr më shumë NATO ndërsa Finlanda Suedia po i bashkohet Aleancës sonë. Ne do të biem dakord për një paketë ndihme gjithëpërfshirëse për Ukrainën.

Dhe më pas unë mirëpres gjithashtu faktin që ne jemi në gjendje të deklarojmë tani se në fakt aleatët europianë dhe Kanadaja po rriten me më shumë trupa,

gatishmëri më të lartë dhe gjithashtu rrisin shpenzimet e mbrojtjes. Shifrat tregojnë se ata kanë shtuar 350 miliardë dollarë shtesë për mbrojtjen që kur kemi bërë zotimin në vitin 2014. Pra, në përgjithësi, kjo tregon unitetin dhe forcën e Aleancës sonë. Faleminderit.

Presidenti amerikan Biden:

Më pyetën për këtë, për Finlandën dhe Suedinë kur secili nga udhëheqësit e tyre erdhi në Shtëpinë e Bardhë. Dhe unë thashë se Putini po kërkonte Finlandizimin e Europës dhe ju do të merrni NATOizimin e Europës. Dhe kjo është pikërisht ajo që ai nuk donte, por është pikërisht ajo që duhet bërë për të garantuar sigurinë për Europën, dhe mendoj se është e nevojshme dhe mezi pres që kjo të ndodhë në një farë mënyre.

NATO publikon Vlerësimin e Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike dhe Sigurisë

Në një raport vlerësimi ‘të kthjellët’ të publikuar më 28 qershor 2022, NATO njeht ndryshimin e klimës si një sfidë gjithëpërfshirëse të kohës sonë që do të rrisë ‘matshëm’ rreziqet për sigurinë dhe do të përkeqësohet ndërsa bota ngrohet më tej. Raporti bën thirrje për një transformim themelor të qasjes së NATO-s ndaj mbrojtjes dhe sigurisë dhe e vendos NATO-n si një organizatë ndërkombëtare udhëheqëse në kuptimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Ky vlerësim është pjesë e një Plani ambicioz të Veprimet për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë që Udhëheqësit e NATO-s miratuan në Samitin e Brukselit në 2021. Ndërgjegjësimi i shtuar do të ndihmojë në informimin e punës së NATO-s për t’iu përshtatur mjedisit të ndryshuar strategjik dhe operativ. Në Dialogun e parë të Nivelit të Lartë mbi Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë të mbajtur në Madrid në margjinat e Samitit të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg njoftoi vendimin e aleatëve për të reduktuar emetimet e gazit me të paktën 45% deri në vitin 2030, në zero neto deri në vitin 2050. Një metodologji e re për matjen e emetimeve të gazit serrë të NATO-s, civile dhe ushtarake, do të ndihmojë në drejtimin e përpjekjeve për reduktimin e gazit. “Kjo është jetike, -tha Sekretari i Përgjithshëm në Dialog, -sepse vetëm ajo që matet, mund të pritë”. Qëllimi është të sigurohet që NATO të ruajë efektivitetin dhe gatishmërinë e saj operacionale në një mënyrë më miqësore me mjedisin. Ngjarja, e cila mbledhi së bashku aleatët e NATO-s, partnerët dhe palët e tjera të interesuara nga e gjithë bota, do të bëhet, nën udhëheqjen e NATO-s, një platformë vjetore për konsultime ndërkombëtare mbi ndryshimin e klimës, adresimin e ndikimeve të sigurisë në një mënyrë bashkëpunuese dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, që u miratua nga krerët e shteteve dhe qeverive aleate njeht gjithashtu, për herë të parë, ndryshimin e klimës si një sfidë kryesore të sigurisë për NATO-n në dekadën e ardhshme.

Turqia hap rrugën për anëtarësimin e Finlandës dhe Suedisë në NATO

Turqia, Finlanda dhe Suedia nënshkruan marrëveshjen që hap rrugën për anëtarësimin e Finlandës dhe Suedisë në NATO

Presidenti i Turqisë Recep Tayyip Erdoğan, Presidenti i Finlandës, Sauli Niinistö dhe kryeministria e Suedisë, Magdalena Andersson u takuan në Madrid të martën (28 qershor 2022) nën kujdesin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg. Në takim, udhëheqësit ranë dakord për një memorandum trepalësh për të adresuar shqetësimet legjitime të sigurisë së Turqisë, duke i hapur rrugën anëtarësimit të Finlandës dhe Suedisë në NATO.

Memorandumi u nënshkrua nga ministrat e jashtëm të tre vendeve, ai i Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu, Pekka Haavisto i Finlandës dhe Ann Linde i Suedisë, në prani të të tre liderëve kombëtarë dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

“Mirëpres fuqishëm nënshkrimin e këtij memorandum trepalësh dhe mirëpres fuqishëm qasjen konstruktive që të tre vendet kanë treguar gjatë negociatave. Anëtarësimi finlandez dhe suedez në NATO është i mirë për Finlandën dhe Suedinë, është i mirë për NATO-n dhe është mirë për sigurinë evropiane”, tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg.

“Sapo kemi përfunduar një takim shumë konstruktiv me Presidentin Erdogan, Presidentin Niinistö dhe Kryeministrin Andersson. Dhe kam kënaqësinë të njoftoj se tani kemi një marrëveshje që i hap rrugën Finlandës dhe Suedisë për t’u bashkuar me NATO-n”, -njoftoi në konferencë për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, menjëherë pas takimit trepalësh mes



Turqisë, Finlandës dhe Suedisë. “Turqia, Finlanda dhe Suedia kanë nënshkruar një memorandum që adreson shqetësimet e Turqisë, përfshirë eksportet e armëve dhe luftën kundër terrorizmit. Asnjë aleat nuk ka pësuar sulme terroriste më brutale se Turqia, përfshirë nga grupi terrorist PKK. Qeveritë e Turqisë, Finlandës dhe Suedisë kanë rënë dakord të rrisin bashkëpunimin e tyre në luftën kundër terrorizmit. Ndërsa aleatët e NATO-s, Finlanda dhe Suedia angazhohen

të mbështesin plotësisht Turqinë kundër kërcënimeve ndaj sigurisë së saj kombëtare. Kjo përfshin ndryshimin e mëtejshëm të legjislacionit të tyre vendas. Goditja e aktivitetëve të PKK-së dhe hyrja në një marrëveshje me Turqinë për ekstradimin”, -tha shefi i NATO-s. “Në dritën e përparimit që kemi bërë së bashku, Turqia ka rënë dakord të mbështesë Finlandën dhe Suedinë për t’u bashkuar me NATO-n. Dua të falënderoj Presidentin Erdogan, Presidentin Niinistö dhe Kryeministrin Andersson për frymën konstruktive të bisedimeve të sotme. Në NATO ne kemi treguar gjithmonë se pavarësisht nga mosmarrëveshjet tona, ne gjithmonë mund të ulemi, të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe të zgjidhim çdo çështje. Politika e dyerve të hapura të NATO-s ka qenë një sukses historik. Mirëpritja e Finlandës dhe Suedisë në Aleancë do t’i bëjë ato më të sigurta, NATO-n më të fortë dhe zonën Euro-Atlantike më të sigurt. Kjo është jetike pasi përballemi me krizën më të madhe të sigurisë në dekada.”

Nga kolana e librit "Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë"

Rajmonda Maleçka, gazetarja dhe fotografja e luftërave të shqiptarëve në Ballkan

Rajmonda Maleçka, pjesëmarrëse si gazetare e luftëtare në luftën e UÇK-së dhe në Maqedoni, mbahet mend si reportere e luftës në front, si shkrimtare e poete që i ka kushtuar luftës, heronjve dhe luftëtarëve të saj edhe disa libra, por dhe si një luftëtare që provoi torturat dhe qëndroi muaj të tërë në burg për shkak të aktivitetit të saj atdhetar. Ajo ka parë me sytë e saj heroizmin e luftëtarëve në front, rënien në vijë të parë të frontit të trimave të lirisë, heronjve e dëshmorëve të saj, duke i përcjellë sistematikisht në medie. Një bisedë me Rajmondën, për jetën dhe aktivitetin e saj, vjen krejt natyrshëm...

Fëmijëria

Fëmijëria e brezit të saj në Tiranë lidhet me interesa të dukshme për shkollën dhe letërsinë në veçanti. Shkolla ishte aktive ngaqë aktivitetet ishin të përditshme, ku gjeje mundësi për të plotësuar vetveten. Ishte një fëmijë që i pëlqente leximi i librave, soditja e natyrës dhe mirësia njerëzore prej nga ka rrjedhur dhe poezia e saj e parë.

Rinia

E shkolluar në një gjimnaz të njohur për nivelin, interesin e talentet që ka nxjerrë. Gjimnazi "Partizani", Rajmonda u lidh përjetësisht me dashurinë për librat dhe historinë e vendit të saj. Dalëngadalë Kosova dhe Çështja Kombëtare do të shndërrohej në objektin kryesor të jetës. Brezi i saj dhe sot vazhdon të jetë pjesa më aktive e zhvillimit të Shqipërisë dhe ringritjes së Kosovës. Ishte koha kur investoi gjithçka në leximin e librave, në të shkruarit e poezive. Është koha për të cilën gjithmonë ndjen rrëmbim sa herë kthen kokën pas. Babai dhe familja ndikoi në momentin e duhur për ta lidhur më shumë me vlerat kombëtare dhe të rëndësishme me të cilat ishin përballur të parët e familjes së saj që nga koha e Skënderbeut e deri sot.

Familja

Babai, nëna dhe vëllai, janë tre shokët e saj më të mirë. I pëlqen t'i quajë shokë, ngaqë kurrë nuk i penguan pasionin dhe interesat e saj intelektuale për të bërë atë që ka bërë deri sot. "Nuk besoj se mund të gjendet femër si unë, më e mbështetur dhe e mirëkuptuar me familjen e vet për të punuar. Jetojmë si qytetarë të thjeshtë duke ruajtur traditën e familjes dibrane prej nga e kemi prejardhjen. Me Dibrën vazhdojmë të mbajmë lidhjet e çdo kohëshme. Im atë, unë dhe po kaq dhe nëna ime Xhumja, e cila nga origjina është tiranase, asnjë rast që vjen, në dasma apo në fatkeqësi, apo rast tjetër nuk e lënë pa e nda prijeten me zakonet e Dibrës dhe të Tiranës, po ashtu dhe kuzhina ajo është. Pra, dhe pse familja ime ka shumë kohë që ka ardhur në Tiranë, pasi kemi pasur dhe shumë prona e tregti në Tiranë, para çlirimit, lidhjet tona janë me Dibrën sikur të kishin ardhur dje nga ai vend, i cili ka pasur dhe ka cilësi të rralla shqiptare. Është nder i madh me qenë nga Dibra dhe dibran apo dibrane", -do të shprehej Rajmonda.

Mbi artin e saj thotë: "Përpiqem të jem vetvetja falë bashkëpunimit që kam me njerëzit e artit dhe të kulturës. Kam botuar njëmbëdhjetë tituj librash, secili është pjesë e jetës sime. Ç'ka dua të them, lidhjen e fortë që arti përcjell me atë që vjen përherë rastësisht e herë nga vëzhgimi. Kam kërkuar të shkruaj një lirikë të thjeshtë, një copë shpirti të hedhur mbi letër. Ndryshe ndodh me poezinë e luftës e cila ka një realitet tjetër, me dhimbjen dhe preludin njerëzor. Atë që gjendet në poezinë time duhet ta besoni se unë e kam prekur më parë. Librat me Poezi "Tungjatjeta Kosovë" dhe "Prelud Pavarësisë" janë realiteti më i prekshëm i jetës sime. Ka qenë dhe mbetet një poezi që më ka afruar edhe me kronikën, prej nga



janë gatuar librat e tjerë që unë i kam shkruar posaçërisht për luftën, qoftë si "Nëpër ditët e dhimbjes dhe lirisë së Kosovës" qoftë tjetri "Ora e Kombit" apo "Tokë Arbnore". Gjithë kjo masë ndjesish i ka plotësuar me një lëndë të bollshme punën time si publiciste, gazetare, madje dhe si fotografe e luftërave të shqiptarëve në Ballkan". Unë ja kam kushtuar jetën librit. Pra koha ime është brenda tyre, për këtë jam e gëzuar dhe e lumtur, pasi në një farë mënyre e kam "fiksuar" kohën, e kam ndalur dhe e kam shndërruar në vlerë të prekshme. Këtë avantazh ka një krijues dhe një shkrimtar, kulturolog apo historian. Në këtë rast dua t'ju tregoj edhe disa libra të tjerë që kam botuar pas Pavarësisë së Kosovës. Libri "Hasi mes luftës dhe lirisë" (2010), përveç se është libri im më emblematic, më i vështirë, është dhe libri më i lodhshëm. Është folur e shkruar për Hasin, njërën nga shtigjet më të rëndësishëm të luftës së UÇK-së, për njerëzit e tij, për ngjarjet, rrethana, personazhe të njohur, për kompleksin e luftës. Ai është një libër shumë-zëshëm ku për këmbëjnë njëra-tjetrën, stili monografik, analiza, dëshmia, kujtimet, rrëfimet dokumenti dhe fotografia. Është një nga librat që peshon shumë në punën time shkrimore. Në vitin 2013 kam botuar një monografi për dëshmorin e kombit, Safet Peci-Boletini dhe vëllimin e parë të serisë poetike "Mbollën gjak mbijne këngë"- një libër voluminoz me 383 balada për dëshmorët e Trojeve Etnike. Libri i 14 është i titulluar "Një President në Bllaçë" - (2016), një reportazh historiko-bashkëkohorë, kushtuar origjinës së familjes time në Dibër. Besoj këto

tituj librash janë një copëz jetë për një vajzë të moshës time.

E kaluara ime: Besoj se pak a shumë i thashë ato që mund të krijojnë një vizatim të thjeshtë për të kaluarën time. Ndoshta më mirë se kudo, e kaluara e njerëzve të mi është e mishëruar tek unë. Ne kemi qenë një familje besimtarësh në Dibër dhe atdhetarësh të njohur që prej viteve 1430 e më pas në Lidhjen e Shqiptarëve të Prizrenit. Dibra në këtë kohë ka qenë treva që ka prodhuar lajme dhe kronika të çuditshme. Me këtë lloj edukimi dhe kupitimesie unë e kam përvetësuar historinë e familjes sime, me çfarë ndjehem mirë ç'kanë bërë ato për ne.

Nacionaliste!? -Po a mund të jetë ndryshe çdo shqiptar që nga viti 1912 e deri më sot? Po a mund të jetë ndryshe çdo shqiptar në ngjarjet e viteve '80 në Kosovë? Unë them jo. Shqiptarët kanë shpalosur gjatë gjithë historisë së tyre dashurinë dhe përkushtimin për trojet, varret, luftëtarët dhe historinë e tyre. S'kanë pushtuar askënd tjetër. S'kanë dhunuar askënd tjetër. Të tjerët kanë bërë ndryshe. Ndoshta është ky formim dhe edukatë që tek unë ka "ndërtuar" këtë marrëdhënie me nacionalitetin e shqiptarëve, i cili në letrat dhe krijimtarinë time kanë një shtrirje të gjerë. Pastaj shqiptarët janë një popull i mrekullueshëm që e mbajnë veten e tyre të lidhur fort me historinë, me zakonet, me etninë, në të gjithë hapësirën e tyre historike. Për këtë i quajmë nacionalistë, termi që në diplomacinë ndërkombëtare nuk shihet me sy të mirë. Por e vërteta është kështu dhe nuk mund të jetë ndryshe. Ne as kemi pushtuar dhe as kemi vlarë njeri. Përkundrazi na kanë vlarë.

Shokët dhe miqtë e mi: Jeta ime ka pasur një ritëm të shpejtë dhe shumë aktiv. Në vitet '90-të, me shumë intensitet në jetën time hyri lufta në Kosovë dhe Çështja Kombëtare. Njerëz me forcë dhe vitalitet të jashtëzakonshëm duket se u bënë pjesë e logjikës dhe e marrëdhënieve të pas viteve '90-të. Luftëtarët më aktivë të UÇK-së, që shkonin e vinin në Tiranë duket se plotësuan vizionin tim për Kosovën. Ishin djem që nuk pushonin për asnjë çast. I gjeje kudo dhe të pakursyer. Në këtë kohë luftëtarët e UÇK-së u bënë njëkohësisht dhe "pronë" e njerëzve publik të Tiranës, të medias dhe të krijimtarisë letrare. Dhe për çudi nëse poezia lirike e shkruar më parë "humbi" brishtësinë, ajo fitoi një cilësi tjetër, më përfaqësuese. Kështu shokët dhe miqtë u bënë më të shumtë, falë edhe singjerit të njerëzor që e përshkonte atë, sepse njerëzit e lirisë e të luftës janë njerëzit më të singertë që kam njohur në jetë.

Unë jam fëmijë mësuesi dhe edukatori, tradita jonë familjare ka pasur një lidhje të fortë me luftërat që nga koha e Skënderbeut e deri në ditët e sotme. Veçmas unë kam pasur një prije për të dëgjuar dhe mësuar histori familjesh, njerëzish, shenjtoreësh dhe luftëtarësh. Në ndërgjegjen time, që fëmijë unë jam edukuar me historinë e luftës së drejtë nga shqiptarët, me luftën e drejtë për t'u çliruar nga pushtuesi. Lufta është t'i përgjigjesh thirrjes së Atdheut për t'iu kundërvënë pushtuesit. Dhe koncepti për luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës i tillë ka qenë brenda meje. Në familje gjithmonë kam dëgjuar për drejtësinë në çështjen e tyre të shqiptarëve të Kosovës. Kur kam marrë pjesë në luftë në Kosovë, idetë i kam pasur të qarta.

Kosovën para viteve '90-të e kam njohur përmes librave të pakët që kam mundur të lexoj, kryesisht Ukshin Hotin si politolog, Qosen, Azem Shkrelin e Podrimen si poet, Rifat Kukaj me romanin "Droja", Sulejman Krasniqin me romanin për Mic Sokolin, pasi gjetja e librave të tyre ishte e vështirë. Një lidhje të fortë mes shqiptarëve kishte krijuar muzika që përcillte një lloj mesazhi të rëndësishëm kulturor dhe shpirtëror. Po kështu, një lloj njohje më kanë afruar dhe takimet e pakta që mund të bëja me turistët nga Kosova që vinin në Shqipëri, dhe jetonin në Perëndim.

Lufta është plotë momente. Çdo moment përjetohet thellë dhe mbetet në kujtesë. Dhe kur niseshe në luftë, fronti i luftës, situatat që vijnë në mënyrë të paparashikuar, ndryshe ajo nuk do të quhej luftë. Përcjellja për në frontin e luftës ka qenë e dhimbshme. Ishin djem të rinj që vinin nga Perëndimi, të cilët nuk e njihnin terrenin e luftës, të heshtur të dëgjueshëm, që nuk ktheheshin pas kurrë dhe pse e dinin se dhe mund të vriteshin. Është një psikologji dhe një marrëdhënie komplekse. Edhe pse kanë kaluar 20 vite para syve të mi do mbeten gjithmonë Bekim

Berisha - Abeja, Bedri Shala, Elton Zherka, Përmet Vula, Bashkim Leku, të rënë në luftimet me serbët në Junik, plagosja e Sabri Alimit dhe mikpritja e Bacit, Avdyll Gjocaj, në Gjocaj të Junikut. Momentet e takimit me Mujë Krasniqin e vëllain e tij Alinë, Beqir Gashin dhe Nuh Gecin etj., luftëtarë liricë që udhëtojnë së bashku me mua në rrugëtimin tim në Kosovë.

Burgu im: Duhet faje të shumta libri të tregoj ç'është burgu. "Shutka" apo "Idrizova" në Maqedoni, më kanë kujtuar kronikat e nazizmit. Burgu në Maqedoni, bashkë me babanë tim Bujar Maleçka, ka qenë dhe mbetet një sakrificë për të mbi ekzistuar. Ishte një realitet, çdo moment i të cilit të provokonte terrorin psikologjik dhe poshtërimin njerëzor. Atje tëurvej çdo gjë. Në ato burgje ndodhet dhe mbahet e izoluar soji i djelmërisë shqiptare. Është dhimbje për shqiptarët sot. Në të ardhmen unë do t'i kushtoj një libër personal burgosjes sime në Maqedoni. Por dhe kështu siç ndodhi, unë besoj se e kam kryer detyrën e gazetarit, sepse në Kosovë kam qenë vetëm për punë të profesionit të gazetarit, një punë që e kam kryer që nga fillimet e lëvizjes së UÇK-së në Shqipëri-Kosovë-Preshevë-Bujanovc-Medvegje dhe Maqedoni.

Për shumë arsye, qofshin të mentalitetit të shqiptarëve, të rrjedhës së historisë, femrës shqiptare i është dashur sakrificë për të mbrojtur dinjitetin e saj. Shqipëria vjen nga një periudhë historike, kur ka vepruar e drejta zakonore, mentaliteti i burnisë si sundues. Mund të lexosh vetëm një përcaktim në cilindo kanun që ka vepruar në Shqipëri, dhe gruas e caktotet të ketë të drejtë të punojë, të lindë fëmijë dhe asgjë tjetër. Ky është një gurë i rëndë në qafën e gruas shqiptare, i cili s'ka arritur t'i hiqet as me një ligj dhe as për një kohë të shkurtër. Neve në zonat urbane duket se ajo (gruaja) ka mundësi ta bëjë vetveten, në zonat rurale, në fshatrat e thella dhe konditat e familjes konservatore, kjo është e vështirë, madje, e pamundur. Pra, e nisa kështu përgjigjen për pyetje, sepse perceptimi për ta vlerësuar gruan më së shumti është i përciptë. Nëse do të na duhej të vlerësonim kontributin e gruas tradicionale, unë do të eidentoj një fakt kokëfortë, çfarë lë të kuptojë se burri dhe gruaja janë të kapërcyen këto vështirësi. U bënë njësh me luftëtarët e tjerë, qëndruan në llogore, derdhen plumba, udhëtuan ditë e natë maleve të rreptë, u plagosën dhe u vranë ashtu si burrat. Më pas në TMK- femrat morën detyra e pozicione të vështira, të rëndësishme dhe të nevojshme. Kurse në kushtet e shoqërisë demokratike ajo është ministere, gazetare, Kryetare Kuvendi, gjyqtare, etj., por të mos harrojmë se ajo i ka fituar këto detyra me aftësitë e saj.

Historitë e dashurisë shpesh janë bërë shkak luftërash dhe revolucionesh. Dihet se dashuria mund të ndryshojë rrjedhën e historisë së botës dhe kjo është vërtetuar më tepër se një herë.

Të gjithë e dimë historinë e dashurisë së Helenës së Trojës dhe Paridit. Mirëpo, është një histori që ka shumë pikëpyetje dhe nuk është e vetmja që ka ndryshuar rrjedhën e historisë botërore. Më poshtë po ju rendisim 5 romancat që ndryshuan rrjedhën e historisë.

Kleopatra dhe Mark Antoni

Kleopatra VII e Egjiptit mbahet mend si femër legjendare e mpleksur me dy historitë e dashurisë më të mëdha ndonjëherë. Megjithatë, partneriteti politik dhe romantik me gjeneralin romak Mark Antony, solli vdekjen e të dyve dhe rrëzoi dinastinë shekullore Ptoleme. Në vitin 41 P.K., Mark Antoni mori përsipër administrimin e krahinave lindore të Romës. Thirri Kleopatren për t'iu përgjigjur akuzave se kishte ndihmuar armiqët e tij.

Duke shpresuar të mashtronte Antonin, siç kishte bërë me Julius Cezarin, Kleopatra mbërriti me një varkë madhështore e veshur si Venera (perëndesha romake e dashurisë). Antoni i mashtruar e ndoqi përsëri në Aleksandri, duke u zotuar të mbronte kurorën e Egjiptit dhe të Kleopatres. Vitin tjetër u kthye në Romë dhe për të provuar besnikërinë e tij u martua me motrën e drejtuesit të Romës (Oktaviani).

Kleopatra, ndërkohë, lindi binjakët e Antonit dhe vazhdoi të sundojë një Egjipt gjithnjë e më të fortë.

Vite më vonë, Antoni u kthye tek Kleopatra dhe shpalli djalin e saj Cezarion si trashëgimtarin e vërtetë të Cezarit. Kjo filloi një luftë propagande me Oktavianin e tërbuar. Ky i fundit pretendonte se Antoni ishte plotësisht nën kontrollin e Kleopatres dhe se do të braktiste Romën për të gjetur një kryeqytet të ri në Egjipt. Në vitin 32 P.K., Oktaviani i shpalli luftë Kleopatres. Një vit më vonë, pra viti 31 P.K., forcat e tij mposhtën ato të Antonit dhe Kleopatres në Betejën e Actium-it. Po pas një viti, Oktaviani arriti në Aleksandri dhe e mundi përsëri Antonin. Pas përfundimit të betejës, Kleopatra u strehua në mauzoleun që kishte ndërtuar vetë.

Antoni, gënjeu se Kleopatra kishte vdekur, dhe më pas vrau veten me shpatën e tij. Më 12 gusht të vitit 30 P.K., pasi varrosi Antonin dhe u takua me Oktavianin fitimtar, Kleopatra u mbyll në dhomën e saj me dy shërbëtorë dhe kreu vetëvrasje. Këtu u mbyllën dhe historitë e dashurisë së saj.

Henry VIII dhe Anne Boleyn

Historianët pranojnë se qenë një kombinim faktorësh ato që shndërruan Anglinë në një komb protestant. Mirëpo, pasioni i Henrit VIII për një femër të re dhe karizmatike të quajtur Anne Boleyn i vuri vulën. Historitë e dashurisë të Henrit përfliken edhe sot. Deri në vitin 1525, monarku ishte hidhëruar me gruan e tij të parë, Katerina e Aragonit. Katolike e devotshme dhe shumë popullore. Katerina nuk arriti t'i sillte në jetë një trashëgimtar mashkull, kështu që syri i tij famëkeq ra mbi Anne Boleyn.



Anne Boleyn ishte një vajzë në pritje për t'u martuar, dinake dhe e bukur. Babai i saj ishte një kalorës dhe diplomat ambicioz.

Ndryshe nga motra e saj Mary, një nga të dashurat e mëparshme të mbretit, Anne rrëmbeu vëmendjen e tij dhe nuk pranoi të joshëj pa i premtuar martesë.

Në vitin 1527 Henri i kërkoi Papa Klementit VII anulimin e martesës së tij me Katerinën, por kjo gjë iu refuzua. I inkurajuar nga këshilltarët kritikë ndaj papatit, ai u martua fshehurazi me Annën në vitin 1533. Në këtë mënyrë u shkëput me Kishën Katolike Romake dhe menjëherë u emërua kryetari i Kishës së Anglisë.

Mirëpo, magjepsja e Henrit me mbretëreshën e tij të dytë filloi të zbehej shpejt. Veçanërisht kur edhe ajo nuk mundi t'i jepte një trashëgimtar mashkull. Më vitin 1536, mbreti e arrestoi Annën dhe e dënoi me vdekje duke i prerë kokën. Arsyeja sipas tij ishin akuzat për magji,

Historitë e dashurisë që ndryshuan rrjedhën e historisë botërore



incesti dhe kurorë-shkelja. Këto akuza në të vërtetë ishin të reme. Pas kësaj, 11 ditë më vonë, ai u martua me Jane Seymour, e treta nga gjashtë gratë e tij.

Në dekadat që pasuan, pyetjet rreth fesë zyrtare të shtetit do vazhdonin ta copëtonin dhe dobësonin mbretërinë. Vetëm pas kurorëzimit dhe mbretërimit 44-vjeçar të Elizabetës I, morën fund këto konflikte. E bija e Henrit me Anne Boleyn, krijoi kishën e përhershme protestante angleze.

Pierre dhe Marie Curie

Kur Marie Sklodowska u martua me Pierre Curie në 1895, çifti nisi një rrugëtim të jashtëzakonshëm. Ky rrugëtim u siguroi atyre famë ndërkombëtare dhe ndikim në gjeneratat e ardhshme të shkencëtarëve.



Lindur në Varshavë të Polonisë, në vitin 1867, Marie ishte nxënëse e shkëlqyer. U dekorua në shkencat fizike dhe matematikë nga Sorbona në Paris.

Në vitin 1894 u njoh me Pierre Curie, një fizikan dhe kimist i shquar francez, tetë vjet më i madh se ajo. Dyshja u lidh menjëherë për shkak të interesit të ndërsjellë mbi shkencën dhe dashurinë për ciklizëm. Një vit më vonë u martuan. Duke kërkuar një temë për tezën e saj të doktoraturës (të intriguar nga zbulimi aksidental i fizikanit Henri Becquerel i radioaktivitetit në vitin 1896) Marie Curie filloi të studiojë. Shumë shpejt edhe Pierre iu bashkua kërkimeve të saj. Në vitin 1898, një vit pas lindjes së vajzës së tyre Irène, të dy zbuluan poloniumin (i quajtur kështu në nder të atdheut të Marie) dhe radiumin. Në vitin 1902 ata izoluan me sukses kripërat e radiumit radioaktiv nga minerali i Uraninite. Një vit më vonë, çifti u nderua me çmimin Nobel në fizikë për punën e tyre marramendëse mbi radioaktivitetin.

Në 1904 Marie lindi një vajzë të dytë dhe Pierre u emërua Dekani i Fizikës në Sorbonne. Dy vjet më vonë, ai vdiq në një aksident fatkeq në një rrugë në Paris. Edhe pse e shkatërrua, Marie u zotua të vazhdojë punën e saj. Ajo u emërua në vendin e burrit të saj në Sorbonne, duke u bërë profesoresha e parë femër e universitetit. Më vonë u interesua për aplikimet mjekësore të substancave radioaktive, përfshirë potencialin e radiumit si terapi kancerogjene. Ajo drejtoi Institutin Radiumit në Universitetin e Parisit, një nga qendrat më të rëndësishme për kiminë dhe fizikën bërthamore. Marie vdiq në 1934 nga leucemia, e shkaktuar nga katër dekada ekspozimi ndaj substancave radioaktive. Irène Curie vazhdoi traditën e familjes, duke ndarë çmimin Nobel të vitit 1935 për kimi me burrin e saj për zbulimin e tyre të radioaktivitetit artificial.

Car Nikolla II dhe Alixe e Hesse

Të vendosur përballë sfondit të trazirave revolucionare, të ngatërruar me një oportunist dhe të varur nga një sëmundje e pashërueshme, jeta e tyre kishte të gjitha elementet e një opere të bujshme. Mbesa e Mbretëreshës së Anglisë Victoria, Alix Victoria Helena Louise Beatrice, e njohur më vonë si Alexandra Feodorovna Romanov, kundërshtoi një martesë të rregulluar me kushërinin e saj të parë, Princin Albert Victor.

Alix, vetëm një adoleshente, ra në dashuri me Nikollën, trashëgimtarin e fronit rus. Po aq i dashuruar edhe princi, bindi babanë e sëmure të pajtohej me bashkimin e tyre. Dyshja u martua në nëntor të 1894, vetëm disa javë pas vdekjes së carit dhe kurorëzimit të Nikollës.



Megjithëse të rrethuar nga trishtime të mëdha, martesa ishte e lumtur dhe e pasionuar. Ata sollën në jetë katër vajza dhe një djalë, Alexei. Nga babai i tij careviçi trashëgoi të drejtën për fronin rus, por nga nëna trashëgoi një sëmundje të rëndë. Hemofilia dhe çrregullimi i gjakut, një gjen bartës nga Alexandra dhe gjyshja e saj.

Të tmerruar nga humbja e Aleksit, ata u mbështetën gjithnjë e më shumë tek "murgu i çmendur" Grigor Rasputin.

Thuhej se trajtimet e hipnozës së Rasputin-it ngadalësonin hemoragjitë e djalit. Ndikimi politik i Rasputinit mbi carin dhe czarinën minoi besimin e publikut rus mbi dinastinë Romanovëve. Kjo solli edhe përmbytjen e tyre gjatë Revolucionit të Shkurtit në 1917. Nikolla, Alexandra dhe fëmijët e tyre u ekzekutuan në 16 korrik 1918, me urdhër të liderit bolshevik Vladimir Lenin. Në mënyrë indirekte, romanca e çiftit mbretëror hapi një kapitull të ri dhe të përgjakshëm në historinë e Rusisë.

Mildred dhe Richard Loving

Richard Loving, një mashkull i bardhë, takoi Mildred Jeter, një mike të familjes që ishte me origjinë afrikano-amerikane. Kur të dy ishin adoleshentë, marrëdhëniet e tyre u kthye në romancë. Historitë e dashurisë të ngjashme si kjo e tyrja ishin të rralla. Në qershor 1958 çifti u nis në Uashington për të shkëmbyer unazat.

Udhëtuari 130 km larg vendit të tyre të lindjes Virxhinias, sepse ligjet i quanin të paligjshme martesat ndër-racore.

Pesë javë më vonë, oficerët e policisë përshkuan derën e tyre dhe zgjuan të porsamartuarit në mes të natës. Kur sherifi e pyeti se çfarë po bënte në shtrat me atë zonjë, 24-vjeçari Riçard tregoi certifikatën e martesës. U arrestuan dhe u akuzuan për "bashkëjetesë si burrë e grua, kundër paqes dhe dinjitetit të Komonuelthit".

Dy të dashuruarit u dënuan me një vit burg dhe me një internim 25-vjeçar nga shteti i tyre i lindjes.

Çifti u zhvendos në Washington, ku jetuan për pesë vjet dhe patën tre fëmijë. Duke humbur familjen dhe miqtë e tyre në shtëpi, në vitin 1963 ata kontaktuan Prokurorin e Përgjithshëm amerikan Robert F. Kennedy, i cili i drejtoi ata në Unionin Amerikan të të Drejtave Civile. Juristët vullnetarë përfundimisht e çuan çështjen deri në Gjykatën Supreme. Në gjyqin historik Loving v. Virginia të vitit 1967, u quajt antikushtetues ndalimi i martesave racore në Virxhinia. Ky ligj u pasua edhe në 15 shtete të tjera. Richard u vra në një aksident automobilistik në vitin 1975. Mildred qëndroi në shtëpinë e saj në Virxhinia derisa vdiq në vitin 2008.

Këto ishin pra, historitë e dashurisë që ndryshuan rrjedhën e historisë botërore.



Samiti i G7

Charles Michel, President i Këshillit European dhe Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit European, përfaqësuan BE-në në samitin e këtij viti të G7-ës të organizuar në Schloss Elmau, Bavari, Gjermani, më 26-28 qershor 2022.

Samiti i G7 ishte një mundësi për të dërguar një sinjal të fuqishëm uniteti në këto kohë të trazuar.

“BE dhe G7 ndajnë të njëjtat qëllime: ndalimi i makinës së luftës së Rusisë, duke mbrojtur ekonominë tona dhe ato të partnerëve tanë”, - u shpreh Presidenti i Këshillit European Charles Michel.

Gjatë takimit tre-ditor, udhëheqësit e G7 diskutuan një gamë të gjerë temash, duke përfshirë: Ukrainën dhe bashkëpunimin në politikën e jashtme; Adresimin e sigurisë së energjisë dhe ushqimit; Investimin në klimë dhe shëndet; Promovimin e partneriteteve për infrastrukturë dhe investime; Formësimin e ekonomisë globale; Avancimin e barazisë gjinore; Formësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Presidenca gjermane ftoi gjithashtu liderët nga Argjentina, India, Indonezia, Senegali dhe Afrika e Jugut për të marrë pjesë në disa sesione pune gjatë samitit.

Në fund të samitit, liderët miratuan një komunikatë, ku në lidhje me Ukrainën udhëheqësit e G7 ritheksuan dënimin e tyre për luftën e paligjshme dhe të pajustificueshme të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.

“Ne do të qëndrojmë me Ukrainën për aq kohë sa të duhet, duke ofruar mbështetjen e nevojshme financiare, humanitare, ushtarake dhe diplomatike në mbrojtjen e saj të guximshme të sovranitetit dhe integritetit territorial të saj”, -thuhet në Komunikatën e liderëve të G7.

Mbështetja financiare nga G7 në vitin 2022 arrin në më shumë se 2.6 miliardë euro ndihmë humanitare.

Vendet e G7 janë gati të japin ose kanë premtuar dhe dhënë 28 miliardë euro ndihmë buxhetore.

Udhëheqësit e G7 janë të përkushtuar fuqishëm për të mbështetur rindërtimin e Ukrainës nëpërmjet një plani dhe konference ndërkombëtare rindërtimi. Vendet e G7 do të vazhdojnë të vendosin sanksione të rënda dhe të qëndrueshme ndaj Rusisë për të ndihmuar në përfundimin e kësaj lufte.

“Ne mbetemi të palëkundur në angazhimin tonë ndaj koordinimit tonë të paprecedentë mbi sanksionet për aq kohë sa është e nevojshme, duke vepruar në unison në çdo fazë dhe do të reduktojmë të ardhurat e Rusisë, duke përfshirë edhe nga ari”, -deklaratë nga Komunikata e liderëve të G7.

Për sa i përket Sigurisë së energjisë dhe ushqimit nën ndikimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, e cila po përkeqëson në mënyrë dramatike sigurinë energjetike dhe aksesin në ushqim në nivel global, udhëheqësit e G7 u angazhuan për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të siguruar furnizimin me energji dhe për të reduktuar rritjet e çmimeve.

Kjo përfshin eksplorimin e masave shtesë si kufizimet e çmimeve.

“Ne riafirmojmë angazhimin tonë për të hequr gradualisht varësinë tonë nga energjia ruse, pa kompromentuar qëllimet tona klimatike dhe mjedisore”, -thuhet në Komunikatën e liderëve të G7, në lidhje me sigurinë e energjisë dhe ushqimit.

Do të heqim gradualisht varësinë tonë nga energjia ruse, pa kompromentuar qëllimet tona klimatike dhe mjedisore



Tryezë e rrumbullakët: Bashkëpunimi në politikën e jashtme dhe të sigurisë

Vendet e G7 do të rrisin gjithashtu sigurinë globale të ushqimit dhe përmes Aleancës Globale për Sigurinë Ushqimore: “Ne do të ofrojmë një shtesë prej 4.5 miliardë dollarësh për këtë qëllim, do t'i qëndrojmë angazhimeve tona për të mbajtur të hapura tregjet tona ushqimore dhe bujqësore dhe për të rritur përpjekjet për të ndihmuar Ukrainën të prodhojë dhe eksportojë.”

Ndërsa për Çështjet ekonomike udhëheqësit e G7 mbeten të përkushtuar për të minimizuar ndikimin e luftës në nivel global, si dhe ndikimin e saj në ekonominë dhe popullsinë e tyre.

Vendet e G7 do të ndihmojnë në stabilizimin dhe transformimin e ekonomisë globale duke trajtuar rritjen e kostove të jetesës për qytetarët.

“Ne do të koordinojmë sigurinë tonë ekonomike, do të forcojmë qëndrueshmërinë e zinxhirëve të furnizimit dhe do të sigurojmë një fushë loje të barabartë”, thuhet në Komunikatën e liderëve të G7.

Udhëheqësit e G7 miratuan qëllimet e një Klubi të hapur dhe bashkëpunues ndërkombëtar për Klimën dhe mjedisin.

Ata do të punojnë me partnerë drejt krijimit të tij deri në fund të vitit 2022.

Objektivat janë: drejtimi i ve-

primeve urgjente, ambicioze dhe gjithëpërfshirëse për t'u lidhur me rrugët 1,5°C dhe përsheptimi i zbatimit të Marrëveshjes së Parisit.

Udhëheqësit e G7 u angazhuan për: një sektor rrugor shumë të dekarbonizuar deri në vitin 2030; një sektor energjetik plotësisht ose kryesisht i dekarbonizuar deri në vitin 2035, duke i dhënë përparësi përsheptimit të largimit të energjisë së pandërprerë të qymyrit vendas.

Udhëheqësit e G7 shqyrtuan progresin e partneritetit të G7 për infrastrukturën dhe investimet në një të ardhme më të mirë.

Nëpërmjet partneritetit, ata synojnë të mobilizojnë 600 miliardë dollarë gjatë pesë viteve të ardhshme për të ngushtuar hendekun global të investimeve.

“BE-ja mbështet plotësisht Partneritetin e G7 për Infrastrukturën dhe Investimet Globale. 46% e ndihmës globale për zhvillim vjen nga BE. Çdo vit, pothuajse 70 miliardë euro shkojnë për financimin e më shumë paqes, më shumë prosperitet dhe më shumë zhvillim”, - deklaroi Presidenti i Këshillit European Charles Michel.

Udhëheqësit e G7 ranë dakord të rrisin bashkëpunimin e tyre globalisht. Duke u mbështetur në partneritetin e

tyre ekzistues me Afrikën e Jugut, ata do të punojnë drejt Partneriteteve të reja të Tranzicionit të Drejtë Energjisë me: Indonezinë, Indinë, Senegalin, Vietnamin.

Në lidhje me COVID-19, udhëheqësit e G7 riafirmuan angazhimin e tyre për qasje të barabartë globale dhe ofrim të sigurt, efektiv dhe të përballueshëm të: vaksinave, terapeutikëve, diagnostifikimit, mallrave të tjera thelbësore mjekësore.

“Për të kapërcyer pandeminë aktuale të COVID-19, ne do të bazojmë sigurimin tonë të mbi 1,175 miliardë dozave të vaksinës vitin e fundit”, -thuhet në lidhje me vaksinat në Komunikatën e liderëve të G7.

Udhëheqësit miratuan gjithashtu paktin e G7 për gatishmërinë ndaj pandemisë. Ata u angazhuan për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj pandemive të ardhshme dhe sfidave shëndetësore.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve sigurisht ishin edhe Vlerat demokratike. Udhëheqësit e G7 do të bashkëpunojnë gjithashtu me shoqërinë civile dhe partnerët për: të forcuar qëndrueshmërinë e shoqërive tona, të promovuar të drejtat e njeriut online dhe offline, për të adresuar dezinformatat dhe për të arritur barazinë gjinore.

Disa nga objektivat kryesore për BE-në gjatë samitit ishin: nënvizimi i veprimeve të BE-së për të mbështetur Ukrainën dhe për të sanksionuar Rusinë, siguri i informacionit në lidhje me aplikimin e Ukrainës për anëtarësim në BE dhe theksimi i përgjegjësisë së Rusisë për rritjen e çmimeve të ushqimit dhe energjisë dhe rritjen e inflacionit.

Për sa i përket klimës, BE theksoi nevojën për të rritur ambicien globale të klimës, përshëndeti nismën e Klubit Klimatik të propozuar nga presidenca e G7 dhe mbështeti partneritetet e tranzicionit të drejtë të energjisë.

BE gjithashtu theksoi nevojën për t'i dhënë fund pandemisë aktuale, diskutuan instrumentin e ardhshëm të pandemisë, demonstroi luftën e BE-së për barazi gjinore si dhe konfirmoi angazhimin e BE-së për të mbrojtur lirinë dhe integritetin e informacionit në sferën dixhitale.

Gjermania mban presidencën e G7 nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022. Tema kryesore e presidencës gjermane është “Përparimi drejt një bote të barabartë”. Ky qëllim është të drejtojë punën e G7 bazuar në pesë fusha veprimi: Planeti qëndrueshëm; Stabilitet dhe transformim ekonomik; Jetë të shëndetshme; Investimi në një të ardhme më të mirë; Më të fortë së bashku.

Samiti i G7 është një forum që luan një rol të rëndësishëm në formësimin e përgjigjeve globale ndaj sfidave globale, duke plotësuar koordinimin ekonomik global të kryer nga G20.

Ai bashkon liderët nga BE-ja dhe Kanada, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara. Samiti i fundit i G7 u mbajt në Cornwall, MB, në vitin 2021.

BE si anëtare e G7. Në vitin 1977, përfaqësues të Komunitetit të atëhershëm European filluan të marrin pjesë në samitin e Londrës. Fillimisht, roli i BE-së ishte i kufizuar në ato fusha në të cilat kishte kompetenca ekskluzive, por ky rol është zgjeruar me kalimin e kohës.

BE-ja është përfshirë gradualisht në të gjitha diskutimet politike mbi axhendën e samitit dhe, që nga samiti i Otavës (1981), ka marrë pjesë në të gjitha seancat e punës së samitit.

BE-ja ka të gjitha përgjegjësitë e anëtarësimit. Komunikata e samitit është politikisht e detyrueshme për të gjithë anëtarët e G7.

Rotacioni i presidencës nga viti 2018 është: Kanada në 2018, Francë në 2019, SHBA në 2020, Mbretëria e Bashkuar në 2021, Gjermani në 2022, Japoni në 2023 dhe Itali në 2024.



Deklaratë e përbashkët e Presidentit von der Leyen dhe Presidentit Biden mbi Sigurinë Europiane të Energjisë

Pas pushtimit të mëtejshëm të Ukrainës, Rusia vazhdon të përdorë gazin natyror si një armë politike dhe ekonomike. Shtrëngimi energjetik i Rusisë ka ushtruar presion mbi tregjet e energjisë, ka rritur çmimet për konsumatorët dhe ka kërcënuar sigurinë globale të energjisë. Kjo u demonstrua së fundmi nga ndërprerjet akute të motivuara politikisht të furnizimeve me gaz në disa shtete anëtare të Bashkimit European. Këto veprime vetëm nënvizojnë rëndësinë e punës që Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European po bëjnë për t'i dhënë fund mbështetjes sonë në energjinë ruse. Ne po punojmë gjithashtu së bashku për të gjetur mënyra për të reduktuar më tej të ardhurat e Rusisë nga energjia në muajt e ardhshëm për të kufizuar më tej aftësinë e Rusisë për të financuar luftën e saj të paprovokuar në Ukrainë. Këto veprime janë hapa të rëndësishëm, të domosdoshëm dhe të menjëhershëm që mund të marrim, por ne gjithashtu e kuptojmë se sfida është e madhe. Për të përballuar sfidën dhe për të mbështetur përpjekjet e Europës, ne krijuam më 25 mars 2022 Task Forcën për Sigurinë Europiane të Energjisë. Që atëherë, Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European kanë bërë hapa të rëndësishëm drejt reduktimit të varësisë së Bashkimit European nga lëndët djegëse fosile ruse duke ulur kërkesën për gaz natyror, duke bashkëpunuar në teknologjitë e efikasitetit të energjisë dhe duke diversifikuar furnizimet me energji. Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European po marrin gjithashtu veprime vendimtare për të reduktuar kërkesën e përgjithshme për lëndë djegëse fosile në përpunje me Marrëveshjen e Parisit dhe objektivin tonë të përbashkët për emetimet neto zero jo më vonë se 2050.

Task Forca është takuar rregullisht për të diskutuar opsionet për të reduktuar kërkesën e Europës për gaz natyror dhe është takuar gjithashtu me palët kryesore të interesit për të promovuar vendosjen e pompave të nxehtësisë, termostateve inteligjentë dhe zgjidhjeve të përgjigjes ndaj kërkesës për energji. Ne do të inkurajojmë Shtetet Anëtare dhe kompanitë europiane dhe amerikane që të arrijnë një objektiv fillestar për vendosjen e të paktën 1.5 milionë termostateve inteligjente të kursimit të energjisë në familjet europiane këtë vit. Në ditët në vijim ne do të mbledhemi me Shtetet Anëtare dhe palët

e interesuara për të diskutuar rekomandimet e politikave të zbatueshme për të përsheptuar vendosjen dhe prodhimin e termostatit inteligjent dhe pompës së nxehtësisë, në një përpjekje për të siguruar që furnizimi për zgjidhjet kryesore të efikasitetit të energjisë po rritet për të përmbushur kërkesën në rritje.

Ne jemi gjithashtu partnerë për të diversifikuar furnizimet me energji në Europë. Ndërsa Rusia ka shkurtuar furnizimet me gaz natyror për disa shtete anëtare të BE-së, Shtetet e Bashkuara dhe prodhues të tjerë janë rritur. Që nga marsi, eksportet globale të LNG-së në Europë janë rritur me 75 për qind krahasuar me vitin 2021, ndërsa eksportet e LNG-së amerikane në Europë pothuajse janë trefishuar. Për të lehtësuar këto përpjekje, Komisioni European dhe Shtetet Anëtare, në përpunje me një mandat të dhënë nga Këshilli European në mars 2022, krijuan Platformën e Energjisë së BE-së për të koordinuar masat për të siguruar furnizime të besueshme dhe të diversifikuara me energji për BE-në, duke përfshirë përmes vullnetit të përbashkët. blerja e gazit të tubacionit, LNG-së dhe hidrogjenit. Komisioni ka krijuar gjithashtu Platformën e parë Rajonale të Energjisë për Europën Juglindore për të mbështetur diversifikimin e gazit të rajonit të varur tradicionalisht nga furnizimet ruse. Shtetet e Bashkuara janë një partner kyç për diversifikimin e furnizimit me LNG. Ne gjithashtu do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë për reduktimin e emetimeve të metanit në nivel global. Së fundmi, nisja e përbashkët me 11 vende të tjera të Rrugës së Energjisë Globale të Metanit do të avancojë si përparimin e klimës ashtu edhe sigurinë energjetike ndërkombëtarisht.

“Armët çudibërëse”

Armët me lazer me energji të lartë po zhvendosen nga laboratorit në fushë. Pas dekadash zhvillimesh nga DOD, vitet e fundit janë parë që armët lazer të zhvillohen dhe të bëhen funksionale. Të nxitur nga përparimet e fundit në teknologjitë e lazerit me fibra, shënjestrimin dhe bateritë, lazerët janë një zgjidhje kryesore për të luftuar dronët mashtrues... si dhe kërcënime të tjera asimetrike.

Çfarë janë armët lazer?

Një armë lazer gjeneron një rreze drite të përqendruar që mund të nxeht dhe djegë një objekt.

Një lazer me energji të lartë mund të djegë një vrimë në një pllakë të trashë çeliku brenda sekondave. Rrezet udhëtojnë me shpejtësinë e dritës, kanë një gamë shumë më të gjerë se predha të rregullta dhe mund të godasin objektivin e tyre me saktësinë maksimale. Armët e tilla mund të funksionojnë gjithashtu në mënyrë diskrete, pasi dërgimi i rrezeve të dritës nuk gjeneron zhurma të larta. Më e rëndësishmja, ato janë shumë ekonomike, pasi nuk nevojitet asnjë municion, përveç energjisë, për të gjuajtur një rreze. TNO, një organizatë holandeze kërkimore që punon në teknologjinë e armëve lazer thotë se çdo goditje e sistemit që ata po zhvillojnë kushton më pak se një euro (rreth një dollar amerikan).

Të gjithë këta faktorë i kanë bërë armët lazer në projekte tërheqëse për ushtritë në mbarë botën. Verën e kaluar, ushtria amerikane njoftoi se kishte testuar një armë të avancuar lazer në një manovër. Në prill, kryeministri izraelit Naftali Bennet shkroi në Twitter se forcat e armatosura të vendit të tij kishin testuar me sukses sistemin e armëve lazer “të parin në botë” që mund të përdoret për të rrëzuar dronët, raketat dhe mortajat.

Shumë vende të tjera, duke përfshirë Francën, Britaninë e Madhe dhe Kinën, janë raportuar se janë duke punuar në projektet e tyre të armëve lazer.

A po përdor Rusia armë lazer në Ukrainë?



Një ushtar ukrainas me një pushkë kundër-dron në Kiev. Rusia pretendon se ka shkatërruar një dron duke përdorur një lazer

“Disa vende po eksplorojnë teknologjinë dhe përdorimin e këtyre llojeve të armëve. Rusia ka të ngjarë të jetë një nga ato vende, -thotë për DW Maarten Lörtzer, zëdhënës i TNO. “Për shkak të konfidencialitetit të këtyre lloj projekteve, ne megjithatë nuk kemi njohuri për statusin”.

“Ne nuk kemi asnjë indikacion për përdorimin e lazerëve, të paktën të lazerve të armatosur, në Ukrainë”, -tha zëdhënësi i Pentagonit John Kirby në një konferencë për shtyp.

Rusia pretendon se ka përdorur armë lazer në fushën e betejës në Ukrainë, megjithëse SHBA thotë se nuk ka parë asnjë provë për këtë dhe Ukraina e ka quajtur atë si propagandë.

Cilat janë armët lazer dhe sa efektive mund të jenë ato në konflikt?



Peresvet thuhet se është një sistem që mund të djegë dronë dhe pajisje të tjera

Yury Borisov, zëvendëskryeministri përgjegjës për zhvillimin ushtarak, tha për TV rus se një prototip lazer i quajtur Zadira ishte duke u vendosur në Ukrainë dhe kishte djegur një dron ukrainas brenda pesë sekondave në një distancë prej 5 km (tre milje). Lazerët janë gjithashtu në gjendje të verbojnë përgjithmonë ushtarët, një funksion i ndaluar sipas një konvente ndërkombëtare të vitit 1995 që ndalon armët që shkaktojnë dëme ose lëndime të tepërta dhe pa dallim.

Kjo ishte si shtesë e një sistemi të mëparshëm lazer të quajtur “Peresvet”, i quajtur sipas një murgu luftëtar ortodoks mesjetar, i cili mund të përdoret për të verbuar satelitët që orbitojnë lart mbi Tokë dhe për t’i parandaluar ata të mbledhin informacion.

“Nëse “Peresvet” verbohët, atëherë gjenerata e re e armëve lazer çon në shkatërrimin fizik të objektivit, shkatërrim termik, ato digjen”, -thotë z. Borisov.

Megjithatë, një zyrtar i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA thotë se ai nuk ka parë asgjë që të vërtetojë raportet e përdorimit të lazerëve në Ukrainë.

Lazeri rus kundër dronëve ukrainas?

Por armët lazer, nëse janë të përdorshme, mund të ndihmojnë Moskën kundër një prej kërcënimeve të saj kryesore në Ukrainë: dronëve.

Me dronët e saj, ushtria ukrainase ka arritur të kapë ushtrinë ruse në këmbë në disa raste. Përveç dronëve ushtarakë të dorëzuar nga vendet e NATO-s, ukrainasit kanë gjuarmuar dhe sulmuar objektivat ruse me dronët e prodhuar nga vetë ata.

“Armët çudibërëse”



Gjenerali në pension i ushtrisë australiane Mick Ryan paralajmëroi që të mos merren shumë seriozisht pretendimet e Rusisë. “Vendi ka një histori të mburrjes për fuqinë e tij ushtarakë”, -tha ai për “Washington Post”.

Ndërkohë, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u tall me pretendimin rus, duke e krahasuar atë me të ashtuquajturat “armë çudibërëse” duke iu referuar propagandës që Gjermania naziste përhapte për armët jo ekzistente si një metodë e luftës psikologjike. “Tregon qartë dështimin e plotë të pushimit dhe dëshmon se Kremlin ka frikë të pranojë se në Rusi u bënë gabime katastrofike në nivelin më të lartë shtetëror dhe ushtarak”, -u shpreh Zelensky në një video në twitter.

Çfarë mund dhe nuk mund të bëjnë armët lazer

Dihet pak për programin e lazerit Zadira, por në vitin 2017 media ruse tha se korporata shtetërore bërthamore “Rosatom” kishte ndihmuar

në zhvillimin e tij si pjesë e një programi për të krijuar armë të bazuara në parime të reja fizike, raportoi agjencia e lajmeve “Reuters”.

Por ka të paktën një vend që ka zhvilluar një armë lazer. Në prill të 2022 Izraeli publikoi video që tregonte një sistem lazer që rrëzonte raketat dhe dronët.

“Izraeli ka testuar me sukses sistemin e ri të përgjimit me lazer “Iron Beam”. Ky është sistemi i parë i armëve me bazë energjie në botë, që përdor një lazer për të rrëzuar UAV-të, raketat dhe mortajat, me një kosto prej 3,50 dollarë për gjuajtje. Mund të tingëllojë si fantashkencë, por është e vërtetë”, -shkruan në Twitter kryeministri izraelit, Naftali Bennet.

Por eksperti i mbrojtjes raketore, dr. Uzi Rubin nga Instituti i Jerusalemit për Strategjinë dhe Sigurinë (JISS) tha se teknologjia e armëve lazer nuk do të ndryshojë ekuilibrin e fuqisë në fushën e betejës në Ukrainë.

“Zelensky ka të drejtë, nuk është një armë për t’u habitur”, -tha ai për BBC. “Atyre iu deshën disa sekonda për të rrëzuar UAV-në. Ka mënyra shumë më të mira për ta bërë këtë, duke përdorur një raketë “Stinger” ose ndonjë raketë kundërajrore do të kishte qenë më e lirë, më e shpejtë dhe me rreze më të gjatë.”

Lazerët punojnë duke dërguar një rreze drite infra të kuqe që ngroh objektivin e saj derisa të digjet. Dr. Rubin thotë se fuqia edhe e armëve të avancuara lazer është ende shumë e dobët për të bërë një ndryshim të rëndësishëm në fushën e betejës dhe armë të tilla kanë një “shkallë të ulët vrasjeje”.

“Nuk është si në “Star Wars”, ku ata drejtojnë një armë lazer te njerëzit e këqij dhe shpejt shtypin një buton dhe i keqi shpërthen. Në realitet, është më shumë si një furrë

me mikrovalë. Nëse dëshironi ta zieni një filxhan me ujë, kërkon pak kohë. Lazeri funksionon në këtë mënyrë. Duhet ta vendosësh në objektiv dhe të presësh derisa të nxeht dhe ta shkatërrojë”, -tha ai.

Lazeri mund të fokusohet vetëm në një objektiv në një kohë, thotë Dr. Rubin, ndërsa sistemet e mbrojtjes raketore mund të angazhojnë objektiva të shumtë në hyrje në të njëjtën kohë.

Për më tepër, lazerët neutralizohen nga moti i keq, sepse nuk funksionojnë në shi ose borë dhe nuk mund të depërtojnë në re.

Megjithatë, “rrezja e hekurt” e Izraelit ka një arsyetim, tha ai, por kryesisht si një mënyrë për të kursyer para. Raketat interceptuese të shtrenjta të “Iron Dome” të Izraelit janë projektuar për të mbrojtur qytetet kryesore nga raketat hyrëse, në vend të predhave të mortajave ose dronëve.

“Lufta me raketa është një luftë burimesh. Është më e lirë të bësh raketa sesa të mbrohesh kundër tyre. Pra, çdo gjë që mund të bësh për të ulur kostot e mbrojtjes është e dobishme, -tha ai, armët e energjisë mund të jenë të dobishme në uljen e kostove, por nuk do të bëjnë revolucion.”

Për më tepër, Rusia mund të përdorë lazer në fushën e betejës për të verbuar ushtarët ukrainas, thotë për Washington Post gjenerali në pension i ushtrisë australiane Mick Ryan, megjithëse kjo është e ndaluar sipas një protokollit të vitit 1995 të shtuar në traktatin e OKB-së që ndalon armët që shkaktojnë lëndime të tepërta ose kanë ndikim pa dallim.

Rusia, SHBA, Britania e Madhe dhe të tjerët janë nënshkrues të këtij protokollit.

Gjatë shpërnguljes së tyre drejt Shqipërisë, rreth 2400 njerëz kanë humbur jetën gjatë rrugës, për shkak të mungesës së ushqimit dhe vuajtjeve. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30 qershor 1994 e shpalli 27 qershorin si “Dita e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë nga shovinizmi grek”.



78 vjet nga gjenocidi grek mbi popullsinë çame

Çamëri, rrënjë dhembshurie

Gjenocidi grek ndaj popullsisë çame nisi më 27 qershor të vitit 1944, nën udhëheqjen e gjeneralit kriminal Napoleon Zerva.

Masakra më e egër ndaj shqiptarëve myslimanë u bë në rajonin e Paramithisë.

Forcat e Lidhjes Kombëtare Republikane Greke hynë në qytet dhe vranë rreth 600 shqiptarë myslimanë. Popullsia e Parathimisë u kap në befasi.

Numri i të vrarëve ka qenë: në Filat 1286, në Gumenicë 192, në Pargë 620 dhe nga 27 qershori 1944 deri në mars 1945, u vranë 2771 civilë.

Si pasojë e këtij gjenocidi, një pjesë e popullsisë myslimane të Çamërisë, u shpërngul dhe u vendos në qytetet shqiptare.

Gjatë shpërnguljes së tyre e ikjes së tyre drejt Shqipërisë, rreth 2400 njerëz kanë humbur jetën gjatë rrugës, për shkak të mungesës së ushqimit dhe vuajtjeve. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30 qershor 1994 e shpalli 27 qershorin si “Dita e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë nga shovinizmi grek”. Komuniteti çam, më 27 qershor të çdo viti, përkujton në Qafë-Botë të afërmit e tyre që u masakruan nga shteti grek.

Data 27 qershor është data e përkujtimit të gjenocidit grek mbi çamët. Po ta vështrojmë historinë, përgjatë gjithë shekullit XX, deri në vitin 2020, shqiptarët kanë pësuar masakra dhe shpërngulje. Hidhet teza gënjeshtare se “çamët e meritonin, ngaqë bashkëpunuan me nazi-fashistët”. Kjo nuk është e vërteta. Goditja e çamëve u përgatit në vitet 1920, ndërsa me “Ligjin Detyrues” 735/8, 15 qershor 1937, u munduan të rivendikojnë diçka. Mirëpo pronat e çamëve u përgjysmuan. Në pronat e tyre u vendosën grekët e Anadollit. Përfaqësuesi grek në Lozanë deklaroi se çamët nuk janë turq pavarësisht se janë myslimanë dhe kështu çamët nuk u përfshinë në traktatin e shkëmbimit të popullsisë. Mbetën në trojet e tyre, mbetën problem politik për shtetin grek, u desh tu ndaheshin tokat në favor të grekëve të ardhur, ndaj duhej gjenocid. Problemi i Greqisë me jo-grekët nuk del në pah vetëm me çamët. Gjithmonë Greqia kishte synim zhdukjen e të ndryshmëve. Pikat kulmore para luftës së dytë janë viti 1890 me ngjarjet e Lefkadës dhe Korfuzit si dhe viti 1931 me ngjarjet e Selanikut, ku shteti grek dhunoi hebrenjtë e Greqisë. Nuk kanë pasur vetëm çamët probleme. Janë zhdukur dhe dëbuar 700 000 hebrenj. Okupacioni grek do të ishte një etapë e zezë për të gjithë shtresat e minoritetit Çam; se gjithnjë dje dhe sot, klika sunduese greke ushqehet nga një “Megaliidhe” e pa masë dhe një shovinizëm i tërbuar. Ngjarjet kanë rrjedhur mbas njëra tjetrës. Populli minoritar ka mbajtur mbi shpinë peshën e rëndë të kësaj shtypjeje, me gjithë rezistencën e masës, po kjo nuk mund të ishte serioze, se ajo përgatitej gjithnjë nga një rreth bejlerësh dhe oportunistësh të cilët udhëhiqnin masën atje ku u interesonte atyre dhe ashtu si e donin ata. Grindjet në mes të këtyre krerëve, ose aferat e grekëve tek këta nuk e lanë kurrë masën që të gjejë rrugën e drejtë dhe të bashkohej në përpjekjet serioze e sidomos në kohët e zgjedhjeve, ku qenë rastet për



të demaskuar dhe goditur politikën e turpshme të klikave greke në fuqi. Paralelisht me politikën ndaj Shqipërisë dhe gjendjen ndërkombëtare aktet e grekëve bëheshin të theksuara ose kamu-floreshin. Më 1922-1924 mbas disfatës që patën grekët, ata vendosën për të bërë shpërnguljen e Çamëve në Turqi, si shkëmbim me grekët e Azisë së Vogël. Por kjo dështoi në sajë të kundërshtimit të popullit, i cili në këtë mënyrë i përgënjeshtroi përpara të huajve të ardhur si arbitër të kësaj çështjeje, pretendimet greke si të nacionalizmit Turk. Pasi u mbyll kapitulli i shkëmbimit, filloi presioni i gjithëllojtë nga ana e aparatit shtetëror grek. Aplikuan sanksione ekonomike: Tregtarët çamë nuk mund të bëheshin grosistë; me një reformë të shtrembër agrare dhe spekulime të tjera në treg, ua rrëmbejnë ekonominë e vendit çamëve duke ua dhënë grosistëve grekë; u merrnin taksa të

rënda; ndodhte që një çam mund të paguante dy tre herë një taksë të paguar. Nuk interesoheshin për rrjetin e komunikacionit; për 20-30 km rrugë që të lidhesh Filati me skelën e Sajadhës u deshën 10-12 vjet për t’u mbaruar. Filati deri në vitet e fundit komunikonte me Janinën me kafshë. Shteti grek aq më pak interesohesh për zhvillimin e bujqësisë; në kanalizimin e fushave, ndihmë farërash e të tjera për ngritjen e produktivitetit të vendit. Në këtë mënyrë që Çamët të ishin të varur nga grekët. Në ushtri dhe kur pranoheshin, nuk gëzonin besimin si gjithë të tjerët dhe përdoreshin më tepër në prapavija, duke ua mohuar shpesh edhe të drejtën e gjuhës.

Ndarja e Çamërisë në dy pjesë

Në fushatat elektorale, për të mos i lënë çamët të votojnë bashkë, e kishin ndarë Çamërinë në dy pjesë: njërën ia ngjithnin

Prevezës dhe tjetrën Janinës, kështu që kurrë Çamët nuk nxorën në parlamentin grek njeriun e tyre. Kjo mënyrë votimi i bënte ata të jenë të varur gjithnjë nga elementët grekë që u paraqiteshin, të cilët bënin politikën e çastit sa për të marrë votën. Çamëve indirekt u është mohuar dhe e drejta e shkollës, aq më tepër e mësimi të gjuhës amtare. Ka qenë një kohë aty nga viti 1936 që u qe ndaluar edhe të folurit Shqip në zyra dhe në Pazar. Klika sunduese greke bënte dhe një politikë përçarëse fetare duke shtruar fanatizmin dhe ngxitur vazhdimisht provokimin me karakter të tillë; që të jenë gjithnjë të përçarë në grindje dhe gjaqe. Por shpesh Çamëria bëhesh edhe lodra e interesave të ndryshme të klikave greke.



“PASHKO VASA, flakadani i gjakuar në të epërmin amanet shqiptarie”

Më 29 qershor të vitit 1892, në Bejrut të Libanit, ndali jeta e Vaso Pashë Shkodranit. U shua një prej veprimtarëve të shquar të Rilindjes Kombëtare; poet, shkrimtar dhe guvernator. Ai lindi në qytetin e Shkodrës, më 17 shtator 1825. I ati quhej Mhill Gjokë Vasa, kurse e ëma Drande Gjegja. Të parët e fisit të tij, nga i ati, ishin shpërngulur nga Mirdita, duke u zhvendosur në djepin ku lindi dhe përkundi veç korifenj, në Shkodër, në atë shtëpi ku sot është shtëpia-muze e Pashko Vasës. Pashko Vasa ishte dhe mbeti një ndër figurat më komplekse në historinë e Lëvizjes sonë Kombëtare. Ai ishte intelektual, historiani, publicisti, romansieri, diplomati dhe atdhetari i shquar i cili tërë jetën e vet e vuri në shërbim të atdheut. Kombi ynë për herë do të mburret për fatin e mirë që në gjirin e vet mban me xhelozit figurat markante si Vaso Pashë Shkodranin. Jeta dhe vepra e Vaso Pashës, janë bërë pjesë e pandashme e historisë dhe e letërsisë së popullit shqiptar.

Një ndër maksimat e njohura të Pashko Vasës është: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, të cilën e kanë keqkuptuar, shtrembëruar, banalizuar e tjetërsuar!

Për brezat e shekullit XXI, që ende nuk e kuptojnë mesazhin e kësaj poezie në thelb, po risjell sqarimin e kësaj maksime për hir të Pashko Vasës.

“Feja e shqiptarit është shqiptaria” është thjeshtë një metaforë, e cila në kohën kur delja e bardhë (Shqipëria) ishte në mes të hienave (shteteve fqinje) dhe në barkun e balenës (Perandorisë Osmane), kjo fjali bënte thirrje për bashkim, për mobilizim, për kryengritje!

Kur e bëjmë analizën e poezisë, e kuptojmë se që të qartësohet një gjë e pa kuptuar, duhet lexuar e rilexuar e tërë poezia dhe jo të shkëputet vetëm rreshti i fundit. Të gjithë e dimë që shqiptaria nuk është fe, së paku sot kemi aq shkollë për të mos qenë kaq naiv dhe mendje cekët.

Pashko Vasa me këtë poezi bën thirrje për bashkim, atëherë kur Perandoria Osmane nuk e njihte kombin shqiptar dhe bënte propagandë se shqiptarët myslimanë janë turq, shqiptarët ortodoksë janë serbë e grekë dhe shqiptarët katolikë janë latin dhe për rrjedhojë shkroi poezinë “O moj Shqypni”.



Ca thonë kam fë, ca thonë kam din;

Njeni: “jam turk”, tjetri: “latin”

Do thonë: “Jam grek”, “shkje” disa tjerë,

Por jemi vllazën t’gjithë more t’mjerë!

E mos shikoni kisha e xhamia;

Feja e shqyptarit asht shqyptaria!

Të ndalemi këtu dhe ta marrim shtruar, ashtu si shqiptaret në mote.

“...mos shikoni kisha e xhamia” - Po ta gjykosh duke e lexuar kallimthi, e keqkupton mesazhin duke paragjykuar se ka bërë thirrje që t’i lëmë kishat e xhamitë. Por jo, mesazhi këtu është:

“mos u ndani në fe, duke u bërë armiq të njëri tjetrit.

“...feja e shqyptarit asht shqyptaria” -

Metaforikisht, shqiptaria është “feja” që na bashkon duke kuptuar se besimi është individual dhe shqiptaria është kolektive. Pra, pa dallim a je mysliman, katolik apo ortodoks mbetesh vëllai im dhe kjo shqiptari përmban shumë elementë që na mbajnë bashkë.

Një figurë shumë e madhe e Rilindjes Kombëtare! Lavdi jetës dhe punës së këtij BURRI FISNIK DHE ATDHE-DASHËS! Një Intelek-

tual i madh dhe patriot si Pashko Vasa, modeli i papërsëritshëm!

Fjalët e Tij janë aktuale dhe sot e kësaj dite. Ndër breza do të kujtohen këto mendje të ndritura, fjala e tyre kushtruese, për ndërgjegjësim dhe atdheadashuri do të jenerohej etydi që do të shoqëroje valëvitjen e flamurit shqiptar.

Të paharruar dhe mirënjohje për ju burrat e penës dhe pushkës të kësaj toke!

Filluan regjistrimet e kandidatëve për ushtarë/ detarë aktivë në FA për periudhën 12 shtator - 18 nëntor 2022 sipas rajoneve



Qendra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura



Qendra e Personel-Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve

për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 12.09.2022 - 18.11.2022, gjithsej 346 kandidatë, (332 meshkuj dhe 14 femra), sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i mëposhtëm:

<https://www.mod.gov.al/.../5539-filluan-regjistrimet-e...>



Qendra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për

Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2022-2023, për 40 (dyzet) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik, Financë), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Jurist (Fakulteti i Drejtësisë), Transport (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Këmbësori/Zbulim (Shkenca sociale/Fakultetet e tjera).

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 11 gusht 2022.

Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i më poshtëm:

<https://www.mod.gov.al/.../5540-qendra-e-personel...>